



APLIKIMI PËRÇMIMIN E SHITJES ME PAKICË DHE TARIFAVE TËSHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES PËR NIVEL TENSIONI PËR VITIN 2016

OSHEE sh.a.

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Adresa : Njësia Nr.5, Rr. “Andon Zako Çajupi”, Pall Conad, Kati III,
Tiranë,
Shqipëri

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
1.1	Vështrim i Përgjithshëm	1
1.2	Përlogaritja e Kërkesës për të Ardhura	3
1.3	Përlogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni	5
1.4	Tarifa për Klientët e lidhur në Tensionin e Mesëm me matje në Tensionin e Ulët	6
1.5	Indeksi i çmimit të konsumatorit	6
1.6	Kursi i Këmbimit Valutor	7
1.7	AKTIVITETE NË PËRMIRËSIM TË TREGUESVE TEKNIKO-EKONOMIKË TË SHOQËRISË.....	8
II.	PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI	20
2.1	Metodologjia e parashikimit të kërkesës për energji elektrike	20
2.2	Parashikimi i kërkesës për energji nga konsumatorët	22
2.3	Parashikimi i aktivitetit të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike.....	23
2.4	Humbjet teknike dhe jo teknike për periudhën 2016 – 2018	25
2.5	Strategjia e përmirësimit të shërbimit ndaj klientit	25
III.	PËRMBLEDHJE TË HUMBJEVE TEKNIKE PËR VITIN 2015	26
IV.	SHPENZIMET PËR MBULIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE	45
V.	PËRLLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)	46
5.1	Përmbledhje për shpenzimet operative	46
5.2	Shpenzime materiale dhe konsumi.....	47
5.3	Shpenzime për personelin	48
5.4	Shpenzimet për Mirëmbajtje.....	48
5.5	Penalitete dhe Gjoha.....	51
5.6	Shërbime korporate.....	51
5.7	Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing.....	51
5.8	Shpenzime për Qera	51
5.9	Shërbime Postare dhe Komunikimi	51
5.10	Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit.....	52
5.11	Shpenzime Ligjore	52
5.12	Konsulencë dhe Auditim	52
5.13	Shpenzime të tjera.	52
VI.	ASETET BAZË TE RREGULLUARA	53
6.1	Investimet (CAPEX).....	53
6.2	Amortizimi.....	58
6.3	Kapitali i punës	63

6.4	Përlllogaritja e Aseteve Bazë të Rregulluara.....	63
VII.	PËRLLLOGARITJA E NORMËS SË INTERESIT TË BORXHIT	63
VIII.	PESHA MESATARE E PONDERUAR E KOSTOS SË KAPITALIT (WACC).....	65
IX.	TË ARDHURAT E KËRKUARA PËR SHPËRNDARËSIN E ENERGISË.....	66
9.1	Shpenzimet Operative të Operatorit të Shpërndarjes.....	67
9.2	Të ardhura nga Lidhjet e Reja dhe Energjia Reaktive.....	67
9.3	Kompensimi i Humbjeve 2012 – 2014.....	67
X.	E ARDHURA E KËRKUAR PËR FURNIZUESIN E KLIENTËVE FUNDORË.....	67
10.1	Shpenzimet operacionale.....	67
10.2	Kosto e Transmetimit	67
10.3	Marzhi i fitimit.....	67
10.4	Kompensimi për Borxhin e Keq.....	68
10.5	Kompensimi i humbjeve 2012 – 2014.....	68
10.6	Përlllogaritja e tarifës për Furnizuesin e Klientëve Fundorë.	71
XI.	PROPOZIM PËR TARIFË MESATARE TË SHITJES NGA OSHEE	71
XII.	TARIFA E MIRËMBAJTJES NË ZERO KWH DHE TË TJERA.....	72
XIII.	PËRLLLOGARITJA E TARIFËS PËR NIVEL TENSIONI.....	72
13.1	Përlllogaritja e shpenzimeve operative	73
13.2	Kosto e humbjeve.....	73
13.3	Vlera e Aseteve Bazë të Rregulluara dhe Përlllogaritja e WACC.....	73
13.4	E ardhura e kërkuar për nivel tensioni dhe tarifa.....	73
13.5	Tarifa për Klientët e Kontraktuar në TM me matje në TU	75
	SHTOJCA	80
A.	STRUKTURA ORGANIZTIVE E OSHEE.....	81
B.	STUDIM PER TRAJTIMIN E HUMBJEVE.....	82

I. PËRMBLEDHJE

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Detyrimi ligjor për përlogaritjen e kërkesës për tarifë të shitjes dhe tarifëtëshërbimit të shpërndarjes për nivel tensioni bazohet në ligjin e ri “Për sektorin e energjisë elektrike” Nr. 43/2015 datë 30.04.2015 si dhe kërkesës së ERE e gjen kompaninë OSHEE në fazën e përpjekjeve të gjithanshme për transformimin dhe ringritjen ekonomike.

Pavarësisht nga rezultatet në përmirësim të dukshëm gjendja ekonomike e OSHEE (vazhdim i CEZ Shpërndarje) vazhdon të jetë rrënuar. Kështu totali i detyrimeve sipas pasqyrës paraprake të Bilancit në 31.12.2015 të shoqërisë ka arritur në 95.1 miliard Lekëve dhe gjendja në kapitalin e vet është(- 56.3) miliard Lekë.

1.1.1 Statusi Ligjor i Shoqërisë

Vendimi i privatizimit të shërbimit të furnizimit me pakicë të energjisë elektrike nga Qeveria Shqiptare në vitin 2009 duke pasur si qëllim përmirësimin e menaxhimit në këtë sektor rezultoi një hap i dështuar. Shitja e 74% të aksioneve të shoqërisë OSSH shoqërisë CEZ a.s dhe krijimi i shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a nën administrimin e shoqërisë çeke jo vetëm që nuk e përmirësoi performancën, por e përkeqësoi atë duke rrezikuar seriozisht edhe furnizimin normal të konsumatorëve me energji elektrike. Si rezultat i mungesës së investimeve dhe problemeve në administrimin e shoqërisë humbjet teknike dhe jo-teknike në fund të vitit 2012 u rritën së tepërmi duke e cuar shoqërinë në mungesë të plotë të likuiditetit gjë që e detyroi Entin Rregulator të Energjisë që në 21 Janar 2013 të heqë liçencën dhe të marrë në administrim të përkohshëm shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a.

Periudha e Administrimit të përkohshëm megjithë përmirësimet nuk pati rezultatet e pritshme, dhe me zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjeve me shoqërinë CEZ a.s. në Tetor 2014, Qeveria Shqiptare kaloi në pronësi të vet 100% të aksioneve duke ndryshuar dhe emrin e shoqërisë nga CEZ Shpërndarje sh.a në “OSHEE” Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

Me kalimin 100% të aksioneve në pronësi të Shtetit Shqiptar, menaxhimi dhe strategjia e shoqërisë OSHEE janë pjesë e strategjisë kombëtare që Qeveria po ndjek në të gjithë sektorët pëfshirë këtu sektorin energjistik pjesë e të cilit është kjo shoqëri.

1.1.2 Ndryshimet në kuadrin ligjor dhe Tregun Energjistik

Qeveria e Shqipërisë paraqiti në fillim të vitit 2015 platformën e Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë Elektrike, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.171 datë 25.02.2015, ku fokusi kryesor ishte përmirësimi i treguesve të performancës së OSHEE-s, reduktimi i humbjeve teknike dhe joteknike, rritja e normës së arkëtimit me qëllim krijimin e një shoqërie financiarisht të qëndrueshme për të garantuar furnizimin e energjisë elektrike konsumatorit tarifor.

Në kuadër të hapave për ndryshime rrënjësore në treguneenergjisë në Shqipëri, Qeveria aprovoi në Parlament datë 30.04.2015 ligji Nr. 45/2015 “Për Sektorin e Energjisë” i cili ndryshon tërësisht modelin aktual të tregut të energjisë, duke liberalizuar shërbimet e shpërndarjes dhe rikonceptuar furnizimin me pakicë të energjisë drejt një transformimi thelbësor.

Ky proces do të shoqërohet me ndryshime në kuadrin rregullator mbi të cilin zhvillon aktivitetin ERE, për të vijuar me ndryshimet nëkontratëne furnizimit me energji të konsumatorëve, duke prezantuar rolin e furnizuesit universal dhe spektrin e konsumatorëve objekt i furnizimit me çmime të rregulluara.

1.1.3 Ngjarjet kryesore gjatë vitit 2015

Paralelisht me ndryshimet sa më lart, kalimi i kuotave të shoqërisë në pronësi të Qeverisë Shqiptare u shoqërua me operacionin më të madh që kishte realizuar shoqëria në lidhje me:

- i) luftën kundrejt paligjshmërisë së furnizimit me energji elektrike për të gjithë kategoritë e konsumatorëve dhe
- ii) rritjen e aftësisë së OSHEE-s për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, kundrejt një mbështetje të gjerë të publikut pagues të rregullt të energjisë, Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Policisë së Shtetit dhe strukturave të tjera mbështetëse.

Në kuadër të veprimeve dhe masave ligjore të ndërmarra, fillimi i periudhës ushtrimore 2015 e gjeti OSHEE përballë një kombinimi sfidash që lidheshin me:

- i) mungesën e theksuar të investimeve në rrjetin e shpërndarjes thuajse të rrënuar,
- ii) energjinë e pafaturuar për shkak të vjedhjeve në sistem, mungesë matësash apo matësa të dëmtuar,
- iii) arkëtimet e pamjaftueshme për energjinë e faturuar nga familjet dhe bizneset si dhe
- iv) një nivel borxhi shumë i lartë për tu mbledhur nga klientët i akumuluar ndër vite.

Gjithashtu me riorganizimin e tregut lind nevoja për të kryer ndarjen formale të operacioneve, duke veçuar funksionin e shpërndarjes (rrjeti shpërndarës) nga furnizimi, sikurse parashikohet në ligjin e ri të sektorit të energjisë elektrike dhe duke e transferuar furnizuesin publik me shumicë dhe atë me pakicë së bashku me stafin, asetet dhe përgjegjësitë e lidhura me të, në këtë entitet të ri brenda periudhës 2015-2017.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të rimëkëmbjes u shoqërua me aplikimin e veprimeve vijuese:

- a. Vënia në jetë e një plani të ri tarifor i cili thjeshtoi veprimtarinë operacionale të OSHEE-së, duke e zhvendosur subvencionimin e shtresave në nevojë me tarifën bazuar në 2 fasha konsumi, nga OSHEE te Qeveria, kundrejt krijimit të çmimit të padiferencuar për konsumatorin familjar.*
- b. Rritjen e efikasitetit menaxherial, rritjen e përgjegjshmërisë për një menaxhim efektiv të shoqërisë, kontrollin e proceseve operacionale me qëllim arritjen e reduktimit të humbjeve joteknike dhe teknike dhe rritjen e normave të arkëtimit.*

-
- c. Pajisjen e klientëve tërësor me matës duke hequr dorë nga praktika e aplikimit të sasive afrofe brenda qershorit 2016*
 - d. Vënien në punë të një sistemi informacioni për aktivitetin e faturim/arkëtimit që të ofrojë besueshmëri dhe saktësi të efekteve të veprimeve të konsumatorëve*
 - e. Realizimi i përditësimit të të dhënave të klientëve të OSHEE-së me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit, krijimin e një sistemi të integruar të trajtimit të ankesë- kërkesave të klientëve dhe raportesh në kohën dhe mënyrën e duhur më qëllim përmirësimin e vendimmarrjes operationale dhe strategjike*
 - f. Shkëputjen graduale të konsumatorëve që furnizohen në 35/20/10/6 kv deri në fund të vitit 2018*

Rezultatet e aksionit të ndërmarë me mbështetje të Qeverisë i kaluan të gjitha pritshmëritë dhe në fund të 3 mujorit të parë 2015 shoqëria arriti për herë të parë të ketë një rezultat pozitiv disa mujor që prej krijimit të saj në vitin 2007. Në fund të vitit 2015 fitimi i realizuar nga aktiviteti ishte 17 miliard Lekë ose rreth 122 milion EURO. Plani agresiv për uljen e mëtejshme të humbjes e cila në vitin 2019 pritet të shkojë në 15.2% do ta përmirësojë edhe me tej gjendjen financiare të shoqërisë.

Sa më lart brenda një kohe shumë të shkurtër shoqëria ka mundur të arrijë rrezultate të jashtëzakonshme dhe të fillojë shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, megjithatë humbjet financiare të jashtëzakonshme të grumbulluara gjatë periudhës 2009 – 2013 kanë krijuar kosto historike të papërballueshme për një periudhë afatshkurtër prandaj rikuperimi i detyrimeve ndaj KESH dhe OST do të fillojë në vitin 2017 dhe do të zgjasë disa vjet.

Rezultatet e deritanishme në uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëttimeve kanë krijuar një bazë të shëndoshë financiare që kompania të fillojë përmirësimin e rrjetit nëpërmjet investimeve me burime të brendshme krahas atyre me mbështetje të huasë së Bankës Botërore. Kjo falë edhe marrëveshjes për shtyrjen dhe pagesën pjesore të detyrimeve ndaj shoqërive të tjera të sistemit KESH dhe OST ndaj të cilave janë edhe pjesa më e madhe e detyrimeve të shoqërisë.

Nga ana tjetër hapja e tregut dhe aplikimi i tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike për nivel tensioni pritet ta dobësojë pozitën e shoqërisë në treg që për rrjedhojë do të ulë të ardhurat. Në këtë kuadër stafi menaxhues po përgatit masat e nevojshme që duhet të ndërmerren në kuadrin e përgatitjes së planit të biznesit 5 vjeçar në mënyrë që të sigurohen rezultate pozitive që do të sigurojnë shlyerjen e detyrimeve të trashëguara të shoqërisë të cilat mbeten shumë të larta.

1.2 Përlllogaritja e Kërkesës për të Ardhura

Në zbatim të metodologjisë e cila bazohet në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Operatorit të Shpërndarjes për vitin 2016 kemi marrë në konsideratë supozimet themelore si vijon:

- i. Përlllogaritja e tarifës në zbatim të ligjeve në fuqi ka marrë parasysh gjendjen tejet të vështirë financiare të trashëguar nga kompania. Në përlllogaritjen e të Ardhurësë Kërkuar janë llogaritur edhe humbjet e viteve të mëparshme që kanë rritur skajshëm detyrimet e kompanisë, por jo pagesat për detyrimet ligjore që kanë lindur nga mospërmbushja në kohë e këtyre detyrimeve.
- ii. Çmimet për Furnizuesin Publik me Shumicë dhe OST me të cilat KESH dhe OST i shesin energji dhe transmetim OSHEE janë të njëjta me ato të vitit në vazhdim 2015 dhe nuk kanë asnjë efekt të shtuar në përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara si për Shpërndarjen ashtu edhe për Shitjen e Energjisë nga OSHEE si Furnizuesi Klientëve Fundorë.
- iii. Çmimi i energjisë për mbulimin e humbjeve bazohet në parashikimin sipas monitorimit të tregut 2015 dhe që mund të ndryshojë duke u llogaritur si kompensim në vitet e ardhshme të përlllogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë.
- iv. Përlllogaritja e kërkesës për energji është bazuar gjithashtu në strukturën aktuale dhe parashikimin për vitin në vazhdim por që në varësi të ndryshimeve në treg mund të jetë gjithashtu objekt i kompensimeve për diferenca në periudha të tjera.
- v. Zhvillimet pozitive të ekonomisë Shqiptare janë marrë parasysh në mosllogaritjen e ndonjë faktori jo pozitiv në provigjionime të mundshme për efekte të raporteve të paqëndrueshme inflative të ekonomisë që mund të përkthehet në rreziqe të rritjes së menjëhershme të shpenzimeve.

Sasia e energjisë së injektuar në sistem për vitin 2016 parashikohet të jetë 6,376 GWH. Sasia e energjisë së shitur parashikohet të jetë 4,715 GWH dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve parashikohet të jetë 1,661 GWH duke parashikuar që niveli i humbjeve të jetë 26%.

Mungesa e investimeve e ka çuar tashmë rrjetin e shpërndarjes së energjisë drejt rrënimimit dhe nevoja për investime është shumë e madhe. Kjo nevojë lidhet jo vetëm me përmirësimet teknologjike të nevojshme në drejtim të cilësisë së shërbimit, por shpesh thjesht dhe vetëm me zëvendësimin e makinerive dhe pajisjeve të cilat kanë mbaruar tërësisht ciklin e jetës. Këto nevoja përcaktojnë një periudhë të gjatë strategjike investimi për të cilin viti 2015 është vetëm vit i fillimit dhe do të vazhdojnë me një intensitet të ngjashëm deri në vitin 2020. Mbështetja kryesore për investimet në vitet e ardhshme mbetet financimi me ndërhyrjen e Bankës Botërore. Investimet për vitin 2016 mbështetur në burime të brendshme të kompanisë dhe në këtë kredi do të jenë 12.8 miliard Lekë.

Administrimi i ri i ka kushtuar rëndësi të madhe kursimit për çdo zë të shpenzimeve megjithatë është ndeshur me nevojën e menjëhershme të tyre për të rritur performancën duke ushtruar një kontroll më të madh mbi asetet në rrjet dhe përdorimin e tyre duke ndikuar në uljen e humbjeve. Në këtë këndvështrim ka një rritje të planifikuar të shpenzimeve për vitin në vazhdim 2016. Kosto e humbjeve dhe detyrimeve të trashëguara kanë sjellë shpenzime për penalitete të cilat rëndojnë shpenzimet operative të kompanisë të cilat pavarësisht metodologjisë do të duhet të pranohen si shpenzime operative të paktën pjesërisht.

Borxhi i keq i llogaritur bazuar në legjislacionin fiskal është llogaritur duke mesatarizuar të dhënat e pritshme nga arkëtimi idetyrimeve korentepër vitin 2016.

Nga përlllogaritjet si më poshtë kërkesa për të ardhura në vitin 2016 kap shifrën e rreth 23.3 miliard Lekë për Operatorin e Shpërndarjes, 30 miliard Lekë për Furnizuesin e Klientëve Fundorë ose 56.3miliard Lekë gjithsej për OSHEE.

1.3 Përlllogaritja e tarifave të shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni

Përlllogaritja e tarifës së shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni kërkesë e ligjit tëri për energjinë si dhe e ERE në vendimin për tarifën e vitit 2016 prezantohet për herë të parë nga kompania OSHEE. Duhet theksuar se metodologjia për llogaritjen e tarifës së shpërndarjes është e paqartë lidhur me ndarjen në nivel tensioni dhe shumë pak e zbatueshme për kushtet e OSHEE, prandaj edhe kjo llogaritje është e vështirë dhe bazohet kryesisht në koeficientë të gjetur të alokimit të shpenzimeve dhe jo në matjen e tyre të drejtpërdrejta si më poshtë:

- i. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë megjithë investimet e vitit të fundit është akoma i rrënuar dhe si i tillë është gati e pamundur të përcaktohen qartë kostot oportune të investimeve të nevojshme për sjelljen e tij në parametra të transmetimit cilësor, prandaj përlllogaritja e kostos së transmetimit për nivel tensioni mund të përmbajë në çdo kohë koeficientë të përafrit vlera e të cilit, mund të jetë e papranueshme metodologjikisht.
- ii. Vetë rrjeti i shpërndarjes së energjisë si pasojë e mungesës së vazhdueshme të investimeve dhe ndërhyrjeve të shpeshta në kushtet e emergjencave është shumë i paqartë qoftë për ndarjen sipas peshës specifike të përdorimit të tij nga paisjet sipas nivelit të tensionit ashtu edhe në përcaktimin e humbjeve për çdo nivel tensioni.
- iii. Sistemi i informacionit (marrjes së të dhënave) për kostot e drejtpërdrejta dhe ato që do të duhet të alokohen në programin financiar SAP nuk është ndërtuar i tillë që të detajojë në mënyrë të qartë këto informacione. Nuk ka akoma ndarje organizative ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Klientëve Fundorë. Për tu ridetajuar do të duhet akoma kohë dhe përgatitje e posaçme.
- iv. Përlllogaritja e përgatitur më poshtë është mbështetur në Kërkesën për të Ardhura dhe Çmimin e importit të energjisë për mbulimin e kostos së humbjeve teknike gjatë shpërndarjes.
- v. Të dhënat që zotërojmë janë të pamjaftueshme për të përlllogaritur vlerën e saktë të Aseteve Bazë të Rregulluara (RAB) për nivel tensioni, prandaj për këtë si edhe për Peshën Mesatare të Ponderuar (WACC) janë përdorur koeficientëshpërndarjeje (allokimin) të cilët mundësojnë përlllogaritjen e të Ardhurave të Kërkuara të Shpërndarjes në nivel tensioni.
- vi. Alokimi sipas koeficientëve të llogaritur mbi bazë të energjisë së shitur për nivel tensioni dhe niveli i humbjeve të njohura për çdo nivel tensioni, kanë qenë baza për shpërndarjen e shpenzimeve operative, shpenzimeve për humbjet e energjisë elektrike

në rrjet dhe vlerës së Aseteve Bazë të Rregulluara si bazë për llogaritjen e të ardhurave për mbulimin e kostos së kapitalit.

Nga përlllogaritjet në zbatim të metodologjisë dhe koeficientëve tëshpërndarjes (alokimit) rezulton se tarifa për tensionin 35 kV duhet të jetë 2.2 Lekë/kw, për tensionin 20 – 6 kV 4.79 Lekë /kw dhe për tensionin e ulët 5.20Lekë/kw. Megjithatë në rast se raporti i shitjes në bazë tensioni ndryshon, ndryshon edhe baza e shpërndarjes (alokimit) dhe përlllogaritjet duhet të ndryshojnë tërësisht.

1.4 Tarifa për Klientët e lidhur në Tensionin e Mesëm me matje në Tensionin e Ulët

Një nga problemet e mbartura me të cilin administrimi i tanishëm i OSHEE është përballur gjatë vitit 2015 është mënyra e matjes së një kategorie konsumatorësh të cilët janë lidhur në tension të mesëm që rrjedhin si pasojë e investimit të pamjaftueshëm dhe në përputhshmëri me standartet teknike të kodit të matjes së bashku me një mori interesash që lidhen me tarifimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.


Kjo mënyrë lidhjeje dhe matje në rrjet shkakton humbje të shtuar të energjisë për sasinë e saj që kalon në paisjet në zotërim të klientëve dhe jo të OSHEE, për rrjedhojë edhe kosto shtesë.

Për të identifikuar këtë humbje që aktualisht nuk është llogaritur si humbje teknike në rrjetin e OSHEE por si humbje joteknike u krye një studim i hollësishëm që verifikoi se humbja e energjisë që shkaktohet në këtë rast në OSHEE është rreth 93 mijë GWH. Ky studim i është bashkëngjitur këtij Aplikimi.

Mbështetur në studimin e kryer nga Divizioni i Shpërndarjes në OSHEE u kryen llogaritjet për përcaktimin e shpenzimeve shtesë të verifikuara sipas tabelave në kapitullin 13 të këtij studimi sipas të cilit tarifa për Klientët e lidhur në Tensionin e Mesëm dhe me matje në Tensionin e Ulët, duke pasur parasysh tarifën bazë të tensionit të ulët dhe shtesën e përlllogaritur të jetë respektivisht 13.1 Lekë/KWh për energjinë aktive, 15.07 Lekë/KWh për energjinë e shitur në kohën e ngarkesës pik të rrjetit dhe 1.97 Lekë/KWh për energjinë reaktive.

1.5 Indeksi i çmimit të konsumatorit


Referuar të dhënave të Institutit të Statistikave INSTAT janë marrë të dhënat e grafikut të mëposhtëm të cilat tregojnë se indeksi i çmimit të konsumatorit për vitin në vazhdim 2016 tenton të jetë 2%.



Megjithë sa më lart mbështetur në të dhënat shumëvjeçare të Bankës së Shqipërisë si dhe në pritshmërinë e treguesve ekonomikë të Shqipërisë në përlllogaritjet për tarifë kemi konsideruar një koeficient inflacioni prej 3%.

1.6 Kursi i Këmbimit Valutor

Sipas të dhënave të mëposhtme të marra nga faqja në internet e Bankës së Shqipërisë për kursin e këmbimit EURO/Lekë 2015 si në grafikun më poshtë dhe tendencës për vitin 2016, kursi i këmbimit për energjinë e importit është marrë 1EURO= 140 Lekë.



1.7 AKTIVITETE NË PËRMIRËSIM TË TREGUESVE TEKNIKO-EKONOMIKË TË SHOQËRISË

1.7.1 Treguesit Kryesorë të krahasuar të OSHEE gjatë vitit 2015

Treguesit kryesorë të performancës së OSHEE gjatëvitit 2015 krahasuar me vitin 2014 paraqiten në tabelën si më poshtë:

000/Leke	Pershkrimi	Realizimi	Realizimi	Diferenca	%
		Jan - Dhjetor 2015	Jan - Dhjetor 2014		
Te ardhurat	Nga aktiviteti kryesor (shitja e Energjise)	49,772,478	42,931,151	↑ 6,841,328	116%
	Te tjera	4,779,139	4,321,125	↑ 458,014	111%
	Gjithsej	54,551,617	47,252,276	↑ 7,299,342	115%
Shpenzimet	Shpenzime Energji dhe Transmetim	30,350,984	34,198,681	↓ (3,847,697)	89%
	Shpenzime Operative	8,526,207	10,728,753	↓ (2,202,545)	79%
	Provizione	(1,525,277)	309,332	↑ (1,834,609)	-493%
	EBITDA	17,199,703	2,015,511	↑ 15,184,193	
	Amortizimi	2,101,724	2,946,673	↓ (844,949)	71%
	Shpenzime Financiare	1,366,127	1,144,290	↓ 221,837	119%
	Tatim Fitimi	2,678,904	2,435,034	↓ 243,870	110%
	Gjithsej	43,498,668	51,762,761	↓ (8,264,093)	84%
REZULTATI I AKTIVITETIT (-Provizionet)		9,527,672	(4,510,485)	↑ 14,038,157	
	Te Ardhura te Jashtezakonshme	3,873,564	-		
REZULTATI I PERIUDHES		14,926,513	(4,510,485)	↑ 19,436,998	
Investimet		2,872,130	698,830	↑ 2,173,300	
ENERGJI (MWH)					
	Energji e Blere	6,494,866	6,935,245	(440,379)	
	Energji e Shitur	4,459,444	4,313,304	146,140	
Humbje %		31.34%	37.81%	↑ -6.5%	

Në tabelën më sipër:

- Gjatë 12 mujorit 2015 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2014 të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike janë 6.8 miliard Lekëmë të larta ose janë rritur me 16%. Ndër faktorët kryesorë janë rritja e sasisë së energjisë së shitur me 3.4%, arkëtimi i kamatëvonesave si dhe çmimi i shitjes.
- Përkundrejt vitit 2014 shpenzimet për blerje energjie janë 3.8 miliardë Lekëmë të ulta ose 11%. Në uljen e shpenzimeve për blerjen e energjisë kanë ndikuar: a) ulja prej 6.5 % e humbjeve në shitjen e energjisë, b) ulja e çmimit të importit.
- Shpenzimet operative janë ulur për 2.2 miliard Lekë ose 21% megjithëse është rritur ndjeshëm intensiteti i punës dhe numri i fuqisë punëtore. Ulje të ndjeshme kanë pësuar gjobat dhe penalitetet
- Rritja e shpenzimeve financiare në krahasim me vitin 2014 lidhet kryesisht me rivlerësimin e detyrimeve dhe zhvlerësimi në kursin e këmbimit të Lekut në krahasim me monedha të tjera.

➤ Investimet në krahasim me vitin 2014 janë rreth 2.2 miliard Lekë ose 3.6 herë më të larta. Në krahasim me buxhetin 2015 janë duke u realizuar me ritme të kënaqshme, me gjithë vonesën në tenderim, për shkak të aprovimit të vonuar të buxhetit.

➤ Të ardhurat e jashtëzakonshme lidhen me shuarjen e detyrimeve sipas VKM Nr.126

1.7.2 Paraqitja e aktivitetit të furnizimit me pakicë të energjisë për periudhën që u mbyll më 31Dhjetor 2015

a- Treguesit mbi numrin e klientëve të shërbyer dhe marëdhënia kontraktuale

Numri i klientëve aktivë në faturim të OSHEE-s në fund të 2015 arriti në 1.2 milion. Krahasuar me periudhat pararendëse 2014 numri i klientëve është rritur në masën rreth 2.4%, rritje që vërehet në kategorinë familjar, në linjë me projeksionet e rritjes së popullsisë e përdorur në parashikimin e kërkesës për energji.

Numri i Klientëvesipas Viteve

Muaj/Viti	2014	2015
Janar	1,162,331	1,186,032
Shkurt	1,163,336	1,187,207
Mars	1,166,215	1,193,539
Prill	1,168,478	1,197,064
Maj	1,171,117	1,199,598
Qershor	1,172,694	1,199,408
Korrik	1,174,112	1,201,739
Gusht	1,176,089	1,205,229
Shtator	1,177,530	1,207,977
Tetor	1,179,652	1,209,316
Nëntor	1,181,877	1,209,949
Dhjetor	1,184,442	1,212,128
Total	1,184,442	1,212,128

Peshën më të lartë e mbartin abonentët familjarë në masën 87% , duke vijuar trendin e viteve pararendëse.

Klientët sipas kategorive

Kategoria	V 2013	V 2014	V 2015
Buxhetor	9,276	9,399	9,558
Jobuxhetor	2,167	2,181	2,290
Privat	143,546	148,075	152,805
Familjar	1,005,786	1,025,013	1,047,475
SHUMA	1,160,775	1,184,668	1,212,128

Klientët e faturuar me matës janë rritur në periudhën deri në 12/2015, ndërkaq që klientët e faturuar afrofe arrijnë në 2.94 % .

Gjatë periudhës që u mbyll më 12/2015 OSHEE ka instaluar një total prej rreth 35 mijë matësa nga të cilët rreth 81% janë instaluar te klientët e rinj, duke përfaqësuar një reduktim prej rreth 50% të kategorisë së klientëve për të cilët aplikohet faturimi afrofe bazuar në vendimin e ERE-s për këtë qëllim. Gjatë periudhës që u mbyll më 12/2015 OSHEE ka realizuar rreth 38 mijë lidhje të reja ku peshën më të lartë, 84%, e mbartin zonat e shërbimit Tiranë, Fier, Durrës dhe Shkodër.

Lidhjet e reja dhe Matësa të Instaluar gjatë 2015

Muaj/Viti	Lidhje të reja pa matës	Lidhje të reja me matës	Lidhje të reja Total	Ndryshimet e matësave	MATËSA TË INSTALUAR 2015
Janar	1,743	2,497	4,240	403	2,900
Shkurt	1,433	1,656	3,089	427	2,083
Mars	1,557	1,937	3,494	457	2,394
Prill	1,393	3,016	4,409	453	3,469
Maj	1,492	3,208	4,700	795	4,003
Qershor	312	2,238	2,550	614	2,852
Korrik	485	1,611	2,096	468	2,079
Gusht	962	3,971	4,933	380	4,351
Shtator	545	2,315	2,860	892	3,207
Tetor	509	1,711	2,220	721	2,432
Nëntor	228	1,002	1,230	608	1,610
Dhjetor	493	2,296	2,789	358	2,654
Total	11,152	27,458	38,610	6,576	34,034

Sa më lart janë reflektuar përpjekjet e planeve të punës së OSHEE-së për kthimin në ligjshmëri të veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike, veprime të ndërmarra në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm.

Gjatë këtyre veprimtarive OSHEE gjatë vitit 2015 ka realizuar rreth 640 mijë kontrole, 330 mijë ndërprerje të energjisë elektrike dhe marrje masash për abuzuesit.

b- Treguesit mbi sasisë e furnizuara me pakicë të energjisë elektrike

Sasisë e furnizuara

Periudha që u mbyll më 31Dhjetor 2015 u karakterizua nga një rritje e sasisë së faturuar ndaj klientëve në masën 3.4% ose rreth 146MWh më shumë se 2014, duke arritur në 4,459MWh kundrejt 4,313MWh në 2014.

Krahasuar me vitin 2013 kjo diferencë është më e rëndësishme duke arritur në 532 MWh ose 13% më shumë për të njëjtën periudhë kohore.

Kjo rritje ka ardhur si pasojë e:

- Rritjes së kontroleve në terren për reduktimin e abuzimit me energjinë
- Kapjen e konsumeve nga klientët
- Rritjen e kontroleve të brendshme me qëllim realizimin në kohë të leximeve dhe mënyrën e duhur të tyre nga stafi i zonave të shërbimit

Treguesit e Sasive të blera dhe të shitura të energjisë GWH

Treguesit e Bilancit 2013	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nent.	Dhjet.	Total 2013
Energji e Blere	744	665	674	546	503	511	547	566	493	533	590	774	7,145
Energji e Faturuar	364	341	348	329	304	305	310	348	320	288	306	364	3,927
Humbje	380	324	325	216	199	206	237	218	173	245	284	411	3,218
Humbje	51%	49%	48%	40%	40%	40%	43%	39%	35%	46%	48%	53%	45%

Treguesit e Bilancit 2014	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nent.	Dhjet.	Total 2014
Energji e Blere	733	632	646	579	541	501	531	556	492	537	546	640	6,935
Energji e Faturuar	389	365	370	372	342	330	336	354	336	352	367	400	4,313
Humbje	345	266	276	207	199	171	194	202	156	185	180	240	2,622
Humbje	47%	42%	43%	36%	37%	34%	37%	36%	32%	35%	33%	38%	38%

Treguesit e Bilancit 2015	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nent.	Dhjet.	Total 2015
Energji e Blere	686	592	595	514	472	466	536	529	459	477	519	649	6,495
Energji e Faturuar	434	404	399	357	325	333	372	374	343	334	359	425	4,459
Humbje	252	188	196	157	148	133	164	155	116	143	160	224	2,035
Humbje	37%	32%	33%	31%	31%	29%	31%	29%	25%	30%	31%	35%	31%

Sipas Bilancit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korr.	Gusht	Shtat.	Tetor	Nent.	Dhjet.	Total
Energji e Blere													
2015 vs 2014	-47	-40	-51	-65	-69	-35	6	-27	-33	-60	-27	9	-440
2015 vs 2013	-58	-73	-79	-31	-31	-46	-11	-37	-34	-56	-71	-125	-650
Energji e Fatur.													
2015 vs 2014	46	38	30	-15	-17	2	36	20	6	-18	-8	25	146
2015 vs 2013	71	62	51	28	21	27	62	26	23	47	53	61	532
Humbjet %													
2015 vs 2014	-10.3%	-10.3%	-9.9%	-5.2%	-5.6%	-5.5%	-6.0%	-7.1%	-6.4%	-4.6%	-2.1%	-3.0%	-6.5%
2015 vs 2013	-14.4%	-16.9%	-15.4%	-9.1%	-8.3%	-11.7%	-12.7%	-9.2%	-9.8%	-16.1%	-17.3%	18.5%	-13.7%
Energji e Blere													
2015 vs 2014	-6.5%	-6.3%	-7.9%	-11.2%	-12.7%	-7.1%	1.1%	-4.8%	-6.8%	-11.2%	-5.0%	1.3%	-6.3%
2015 vs 2013	-7.8%	-11.0%	-11.7%	-5.7%	-6.1%	-8.9%	-1.9%	-6.5%	-6.9%	-10.4%	-12.0%	16.2%	-9.1%
Energji e Faturuar e Blere													
2015 vs 2014	11.8%	10.4%	8.0%	-4.1%	-4.9%	0.7%	10.6%	5.7%	1.9%	-5.0%	-2.1%	6.3%	3.4%
2015 vs 2013	19.5%	18.3%	14.6%	8.5%	6.8%	9.0%	20.1%	7.5%	7.1%	16.2%	17.3%	16.9%	13.6%

Trende të përmirësuara në sasi të e furnizuara vërehen në sasi të sipas llojit të matjes si rezultat i rritjes së numrit të abonentëve me matës. OSHEE ndërkaq po punon për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në sistemin e faturimit me qëllim evidentimin sa më të mirë të sasive të shitura dhe mënyrën e aplikimit të tarifimit –me matje /pa matje që rrjedhin nga:

- Demontim matësi që përfaqëson konsum me matje: në periudhat 2013-2015 paraqitur në zërin afrofe
 - Rillogaritje si pasojë e testimit të matësit që përfaqëson konsum me matje- në periudhat 2013-2015 paraqitur në zërin afrofe
 - Zerim të matësit si pasojë e arritjes së numërorit të leximit
 - Rillogaritje si pasojë e koeficientit të TRI etj
- që më herët trajtoheshin si faturime afrofe duke mos treguar veprimin real të realizuar dhe konfunduar krahasimin kapje konsumi mujor që vjen nga leximi i matësve
- Sasia e faturuar përfshirë të gjithë elementet sa më lart arrin në masën 5% gjatë periudhës që u mbyll më 12/2015.

d- Treguesit e arkëtimeve për detyrimet e lindura gjatë vitit 2015

Periudha 2015 u karakterizua nga një boom i arkëtimeve për faturën e emtuar gjatë 2015, që ka rrjedhur si kombinim i alternimit të kushteve të pagesës së aktmarrëveshjeve të detyrimeve të prapambetura dhe rritja e ndërgjegjësimit të kategorive të konsumatorëve për nevojën e pagesës në kohë të detyrimeve.

Arkëtimet për faturën e furnizimit me energji elektrikë të OSHEE 2015 arritën në lek 64.7 miliard. Kjo shumë përmban

- Arkëtime për faturat e viti 2015
- Arkëtime për detyrime për faturat e viteve pararendës
- Arkëtime për kamatvonesat
- Arkëtime për këstet e Aktmarrëveshjeve

Arkëtimet Totale Mujore për 2013-2015

<i>Muaj</i>	<i>Njësia</i>	2013	2014	2015
<i>Janar</i>	000 lek	2,679,466	3,898,243	6,232,652
<i>Shkurt</i>	000 lek	3,203,437	3,803,156	7,355,654
<i>Mars</i>	000 lek	3,667,432	4,078,745	6,209,632
<i>Prill</i>	000 lek	3,603,365	4,011,761	5,119,375
<i>Maj</i>	000 lek	3,176,588	3,722,350	4,927,551
<i>Qershor</i>	000 lek	2,549,584	3,363,619	4,608,771
<i>Korrik</i>	000 lek	3,222,797	3,499,229	4,885,019
<i>Gusht</i>	000 lek	3,306,208	3,428,227	5,123,147
<i>Shtator</i>	000 lek	3,352,020	4,563,098	5,247,969
<i>Tetor</i>	000 lek	3,212,609	4,098,791	5,102,061
<i>Nentor</i>	000 lek	2,979,109	4,368,117	4,576,195
<i>Dhjetor</i>	000 lek	3,622,871	6,361,947	5,236,646
Total	000 lek	38,575,487	49,197,282	64,624,672

Arkëtimet Totale Mujore për 6m-Ire 2013-2015

Muaj	Njësia	2013	2014	2015
Janar	000 lek	2,679,466	3,898,243	6,232,652
Shkurt	000 lek	3,203,437	3,803,156	7,355,654
Mars	000 lek	3,667,432	4,078,745	6,209,632
Prill	000 lek	3,603,365	4,011,761	5,119,375
Maj	000 lek	3,176,588	3,722,350	4,927,551
Qershor	000 lek	2,549,584	3,363,619	4,608,771
Total	000 lek	18,879,872	22,877,873	34,453,636

Në tabelë shihet një rritje sinjifikative e arkëtimeve totale gjatë vitit 2015 krahasuar me 2013 dhe 2014 ku vërehet një rritje prej 43% më shumë në 2015 vs 2014 dhe afërsisht 2 fishin krahasuar me vitin 2013.

Shpërndarja e arkëtimeve për faturë, pa përfshirë arkëtimet e kamatave, sipas segmenteve dhe vonesës së arkëtimit tregon një rritje të konsiderueshme në segmentin familjar me Lek rreth 10 miliard krahasuar me vitin 2014.

OSHEE për qëllime të matjes së performancës përllongarit efektivitetin e aktivitetit të arkëtimeve bazuar në treguesin e Normës së arkëtimit totale e cila përllongaritet Arkëtime mujore mbi Faturimin e muajit.

Norma totale e arkëtimit, e cila përfaqëson tërësinë e arkëtimeve pa kamatëvonesë në raport me tërësinë e faturimeve të të njëjtës periudhë, për 12/2015 ka arritur në 98.4% kundrejt 88% në 12/2014 (77%: 12/2013). Rritjen më të lartë e mbart kategoria familjar e ndjekur nga Privat.

e- Cilësia e portofolit të debitorëve dhe veprimet e ndërmarra për reduktimin e borxhit të klientëve

Në fund të vitit 2014 OSHEE trashëgoi një portofol detyrimesh të papaguara nga klientët që kanë origjinën që prej viti 2007. Vlera totale e detyrimeve të mbartura përbëhet nga detyrimi për fatura (principal) dhe kamatëvonesa për detyrimet e papaguara që llogaritet në masën 0.1% në ditë deri në një maksimale prej 100% të detyrimit të paguar.

Detyrimet e Klientëve në 31 dhjetor 2014

Segmenti	Njësia	Principal	Kamatë	Detyrimi deri në fund 31.12.2014
Buxhetor	Mijë leke	2,316,259	2,320,971	4,637,230
Jo-Buxhetore	Mijë leke	3,002,272	3,081,412	6,083,685
Privat	Mijë leke	8,836,554	7,366,583	16,203,137
Familjare	Mijë leke	53,693,452	43,228,766	96,922,218
Grand Total	Mijë leke	67,848,538	55,997,732	123,846,270

Detyrimet e Klientëve në 31 dhjetor 2014 te paguara ne 31/12/2015

Segmenti	Njësia	Principal	Kamatë	Detyrimi i akumuluar deri 31/12/2014 i papaguar deri në fund 31.12.2015
Buxhetor	Mijë leke	990,174	1,045,648	2,035,822
Jo-Buxhetore	Mijë leke	779,967	760,593	1,540,560
Privat	Mijë leke	45,473,669	36,844,674	82,318,344
Familjare	Mijë leke	6,786,328	6,473,303	13,259,630
Grand Total	Mijë leke	54,030,137	45,124,219	99,154,356

Gjatë muajit Dhjetor 2014 dhe në vijim të vitit 2015 OSHEE hodhi në treg një sërë produktesh të ripagesës së detyrimeve të prapambetura me qëllim:

- Reduktimin e detyrimeve
- Rritjen e normës së arkëtimit të faturës korrente

Për të 2 kategoritë kryesore të cilat mbartin detyrime që arrijnë në 112 miliard lek. Në fund të vitit 2015 këto detyrime për 2 kategoritë kryesore arritën në 95 Miliard Lek duke paraqitur një reduktim prej 17 miliard Lek ose rreth 15% reduktim i vlerës së detyrimeve.

Gjatë periudhës që nga hedhja e produkteve në treg OSHEE ka futur në AKM rreth 50% të detyrimit të prapambetur, ndërkaq që po punon për përthithjen e klientëve të tjerë.

Po njëjloj gjatë 2015 u punua me qeverinë për reduktimin e borxhit të BJB kundrejt veprimeve të net-off me KESH për Detyrimet e BJB dhe Detyrimet e KESH për konsumatorët e zonave të përmbytura nga hapja e digave.

Në fund të vitit 2015, në vijim të analizave të portofolit u vendos që të fillohej procedura e përmbarimit për rreth 100 mijë klientë të cilët mbartin një detyrim prej 35 miliard Lek, ndërkaq që për klientët në nevojë, pensionistë dhe kategori të tjera vunerabël po ofrohen produkte ripagese me kushte lehtësuese.

Ndër masat e tjera të marra OSHEE aplikoi gjatë vitit 2015 masat e parashikuara në kontratën e furnizimit për ndërprerjen e furnizimit. Si rrjedhojë gjatë vitit 2015 u realizuan rreth 650 mijë verifikime të debitorëve, ndërkaq që u ndërpre furnizimi në 340 mijë prej tyre, duke përfaqësuar rreth 55% të ndërprerjeve. Nga këto vizita rreth 10% u realizuan në prezencë të policisë gjatë të cilave u ndërmorrën 1500 veprime ligjore.

Vizitat dhe Ndërprerjet e furnizimit

Viti	Muaj	Total Kontrolle	Total Ndërprerje	% e Ndërprerjeve
2014	Nentor	90,153	52,845	58.6%
	Dhjetor	86,917	46,481	53.5%
2015	Janar	59,944	28,780	48.0%
	Shkurt	63,525	30,775	48.4%
	Mars	65,646	28,884	44.0%
	Prill	59,273	29,507	49.8%
	Maj	58,336	36,681	62.9%
	Qershor	34,374	18,314	53.3%
	Korrik	55,687	34,728	62.4%
	Gusht	51,860	31,358	60.5%
	Shtator	46,850	26,778	57.2%
	Tetor	45,495	24,923	54.8%
	Nentor	48,496	24,015	49.5%
	Dhjetor	47,335	23,688	50.0%
Total Nëntor '14 - Dhjetor '15		813,891	437,757	53.8%

f- Analiza e kërkesës për energji , treguesit e humbjeve teknike dhe joteknike

Plani i veprimeve të ndërmarra nga OSHEE në mbështetje me grupet e interesit parashikon që për vitin 2015 të arrihet një tregues i humbjeve në masën 31.8%, ndërkaq që realizimi ka qenë

në masën 31.3% bazuar në parashikimin përkatës. Gjatë 2015 ka një përmirësim të treguesve ndaj planifikimit në masën :

- reduktim të kërkesës në masën 7% krahasuar me 2014
- rritje të faturimit në masën 4% krahasuar me 2014

Sa më sipër çuan në mbajtjen nën kontroll të humbjeve totale teknike dhe jo teknike bazuar në parashikimet e planit, dhe duke i reduktuar në masën 9.5% krahasuar me 2014 dhe 12.5% me periudhën 2013. Reduktimi i humbjeve ka ardhur si pasojë e reduktimit të humbjeve jo teknike që rrjedhin nga një plan veprimesh i OSHEE-s për arritjen e këtij qëllimi. Këtu përmendim:

- Verifikimi sistemim matjeje
- Sistemimi i kabinave dhe boxeve
- Instalimi i matësve dhe reduktimi i faturimit afrofe
- Kontrollë të vazhdueshme në terren në bashkëpunim me policinë
- Plane pune për kapjen e konsumeve në kategoritë privat
- Kontrollë të kategorive të evidentuara gjate procesit të leximit Etj.

Humbjet Teknike dhe Jo teknike për vitin 2013- 2014 -2015-2016

Humbjet 2013	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	Tetor	Nentor	Dhjet.	Viti '13
Humbjet totale në OSHEE Sh.a (%)	51.1%	48.7%	48.3%	39.7%	39.5%	40.3%	43.3%	38.5%	35.1%	46.0%	48.1%	53.0%	45.0%
Humbjet teknike në njësitë e TL (%)	3.1%	2.6%	2.2%	2.6%	2.3%	3.1%	3.0%	3.0%	2.9%	3.1%	3.1%	3.1%	2.8%
Humbjet Teknike (%)	12.5%	13.0%	13.3%	13.0%	13.2%	12.5%	12.6%	12.6%	12.7%	12.5%	12.5%	12.5%	12.7%
Humbjet Jo Teknike (%)	37.1%	34.4%	33.8%	25.1%	24.9%	25.9%	29.0%	24.0%	20.5%	31.8%	33.9%	39.1%	30.7%

Humbjet 2014	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	Tetor	Nentor	Dhjet.	Viti '14
Humbjet totale në OSHEE Sh.a (%)	47.0%	42.1%	42.8%	35.7%	36.9%	34.1%	36.6%	36.4%	31.7%	34.5%	32.9%	37.5%	37.8%
Humbjet teknike në njësitë e TL (%)	2.7%	3.0%	3.2%	3.6%	2.8%	2.7%	2.8%	2.8%	2.4%	2.5%	2.4%	2.3%	2.8%
Humbjet Teknike (%)	18.8%	18.6%	18.5%	18.1%	18.8%	18.8%	18.8%	18.8%	19.1%	19.0%	19.1%	19.2%	18.8%
Humbjet Jo Teknike (%)	26.7%	21.8%	22.5%	15.2%	16.3%	13.4%	16.0%	15.8%	10.9%	13.8%	12.2%	16.9%	17.3%
Humbjet 2015	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh.	Korrik	Gusht	Shtat.	Tetor	Nentor	Dhjet.	Viti '15
Humbjet totale në OSHEE Sh.a (%)	36.7%	31.8%	32.9%	30.5%	31.2%	28.6%	30.6%	29.3%	25.3%	29.9%	30.8%	34.5%	31.3%
Humbjet teknike në njësitë e TL (%)	2.7%	2.6%	2.4%	2.4%	2.2%	2.2%	2.4%	2.6%	2.0%	2.7%	2.8%	2.9%	2.5%
Humbjet Teknike (%)	18.9%	19.0%	19.1%	19.1%	19.2%	19.2%	19.1%	18.9%	19.5%	18.9%	18.8%	18.7%	19.0%
Humbjet Jo Teknike (%)	16.1%	11.1%	12.1%	9.7%	10.4%	7.7%	9.8%	8.5%	4.4%	9.1%	10.1%	13.9%	10.6%

g- Mbrojtja e konsumatorit dhe cilësia e shërbimit të klientit

Gjate vitit 2015 njw nga objektivat e OSHEE's ka qënë përmirësimi i aktivitetit të marrëdhënies me klientin duke u fokusuar në:

- Rritjes e cilësisë së shërbimit të klientit
- Rritjes së masën së mbulimit me qëndra shërbimi – kundrejt krijimit të 90 qëndrave të shërbimit
- Përmirësimi i rregullave dhe procedurave me qëllim zgjidhjen brenda afateve kohore të kërkesa ankesave – duke ndarë qartësisht tipologjitw e kërkesa ankesave
- Rritja e përfshirjes së rajoneve dhe agjensive në zgjidhjen e kerkesave/ankesave duke ju deleguar të drejta që lidhen me aprovimin e ceshtjeve dhe krijimit e qendrave te trajtimit

- Rritja e transparencës në shërbimin e klientit kundrejt investimit në teknologji informacioni - duke realizuar
 - o implementimin e sistemit të ndjekjes së ankesave kërkesave – për montimin e punës së stafit të shërbimit, stafit të përfshirë në procese
 - o ofruar mundësi konsumatorëve që të ndjekin çdo kohë statusin e tyre dhe përgjigjen
 - o caktimin e hapave të qartë të punës për çdo njësi të përfshirë në shërbimet
- Zgjidhjen e ankesave të depozituara deri në dhjetor 2014 dhe që nuk kanë pasur një përgjigje
- Caktimin për vitin 2016 të treguesve të performancës së Shërbimit në nivel rajoni dhe agjensie
- Etj

Gjatë vitit 2015 u vërejt një rritje e fluksit në sportelet e klientëve për ankimime në lidhje me detyrimet e prapambetura që e kanë origjinën që në vitin 2007, duke shprehur në kwtw mënyrë dhe rezultatet e punës për rritjen e arkwtimeve dhe sensibilizimin e konsumatorit ndaj detyrimeve të prapambetura.

Sa më sipër, gjatë vitit 2015 janë depozituar rreth 121 mijë kërkesa/ankesa për shitjen dhe 63 mijë për teknikën, për një total prej 184 mijë kërkesa dhe ankesa, nga të cilat, janë zgjidhur rreth 115 mijë kërkesa/ankesa për shitjen dhe 51 mijë për teknikën ose një total prej 167 mijë. Raport i zgjidhshmërisë totale është në nivelin prej 90% ku çështjet për shitjen janë të zgjidhura në masën 95% dhe të teknikës në masën 80% .

Vërejmë që gjatë vitit 2015 janë zgjidhur dhe rreth 52 mijë çështje të shitjes dhe 18 mijë të teknikës të depozituara ndër vite 2012-2014 dhe të pazgjidhura duke e çuar totalin e çështjeve të vjetra të zgjidhura në 2015 në 70 mijë.

h- Strategjia e përmirësimit të shërbimit ndaj klientit

Treguesit e kërkesë -ankesave për aktivitetin e furnizimit me pakicë tregojnë që konsumatorët afrohen në sportelet për :

- Ankesa për faturim
- Kërkesa për ndryshime emri
- Kërkesa ndryshimi plani tarifor

Dhe

Treguesit e kërkesave për aktivitetin e shpërndarjes tregojnë që konsumatorët paraqesin kërkesa për:

- Lidhje të reja
- Spostime
- Etj

Më qëllim përmirësimit të perceptimit të konsumatorit dhe rritjes së kënaqësisë së shërbimit ndaj tij, OSHEE ka ridefinuar përgjegjësitë dhe rolet e paleve në lidhje me zbatimin në kohë të kërkesave ankesave për çështje teknike, pjesë e strategjisë së OSHEE's për vitin 2016

Pjesë e përpjekjeve për përmirësimin e shërbimit të klientit OSHEE janë hapat e rëndësishëm që lidhen më:

-
- Përditësimin e të dhenave të konsumatorëve
 - Kritjen e transparencës gjatë procesit të leximit
 - Instalimin e teresorëve të sistemi të matjes
 - Riorganizimin e shërbimit të klientit duke kaluar përgjegjësinë e cilësisë së shërbimit në zonën e shërbimit, duke krijuar ambjentin për vetëm një ndalesë të konsumatorit dhe reduktimin e zvarritjes nëpër zyrat e OSHEE's
 - Reduktimin e kohës së përgjigjes ndaj konsumatorit për ankesa të kërkesave dhe lehtësimin e procedurave operacionale (dhënie fuqie autorizimi në nivele rajonale dhe agjensie)
 - Riorganizimin e roleve dhe funksioneve të monitorimit dhe mbikqyrjes së marrëdhënies me klientin në qëndër me qëllim rritjen e kapaciteteve të stafit në shërbim në gjithë territorin dhe evidencimin në kohën e duhur të çështjeve të cilësisë në vëmendje të drejtimit për
 - Prezantimin e teknologjive të informacionit për ndjekjen e ecurisë së kërkesave dhe ankesave dhe kontrollin e afatave të përgjigjeve dhe llojet e përgjigjeve
 - Krijimin e qendrave të trajtimit të ankesave për faturimin në mënyrë që të sigurohet arritja e cilësisë së shërbimit të lexim/faturimit dhe evidencimin në kohë të çështjeve specifike
 - Brandimin të shërbimit të klientit me qëllim komunikimin e identitetit dhe organizimin e ri të kompanisë

1.7.3 Aktiviteti i Shpërndarjes

a. Situata aktuale në Rrjetin e Shpërndarjes

Rrjeti Shpërndarës po kalon në një fazë tranzitore ku po u jepet zgjidhje problematikave shumë serioze që janë shfaqur ndër vite në kompaninë OSHEE sh.a. Kështu mund të përmendim :

- Vjetërsia e rrjeteve dhe pajisjeve
- Shfrytëzimi i një pjese të konsiderueshme të tyre në regjim të mbingarkuar.

Këto kanë sjellë që OSHEE sh.a të përballet me vështirësi të theksuara në menaxhimin e rrjetit, vështirësi të cilat janë reflektuar në cilësinë e furnizimit të konsumatorit, pra me një përkeqësim të tre treguesve të performancës të një kompanie të shpërndarjes si :

- o SAIDI - Nr.i orëve të ndërprerjeve gjithsej/Nr. Konsumatorëve Total
- o SAIFI - Nr.i konsumatorëve të prekur nga ndërprerjet/Nr. Kons.Total
- o CAIDI - Nr.i orëve të ndërprerjeve gjithsej /Nr. Kons. Të prekur nga ndërprerjet

b. Humbjet teknike

Tabela e mëposhtme tregon nivelin e humbjeve teknike për vitin 2015 sipas studimit të Divizionit të Shitjes ku sikundër shihet niveli i humbjeve teknike është shumë i lartë ,20.6%. Edhe për vitin 2016 niveli i humbjeve teknike pritet të jetë njëjtë pasi efekti i investimeve të reja që do të futen në punë do të japin efektin e plotë në vitin 2017:

Nr.	Rajoni	Energjia blere (MWh)	Humbjet ne TL (MWh)	Humbjet ne TM (MWh)	Humbjet ne TU (MWh)	Humbjet ne Total (MWh)	Humbjet ne Total (%)
1	Kukes	120,470	3,356	18,340	19,638	41,334	34.31%
2	Shkoder	659,563	24,282	56,218	66,485	146,985	22.29%
3	Burrel	369,099	9,671	26,377	71,707	107,755	29.19%
4	Durres	896,968	27,663	60,837	42,884	131,384	14.65%
5	Tirane	2,219,548	31,306	97,386	380,121	508,813	22.92%
6	Korçe	275,339	5,907	25,688	11,665	43,260	15.71%
7	Elbasan	387,957	6,701	24,129	25,574	56,404	14.54%
8	Berat	358,457	15,659	26,093	51,767	93,519	26.09%
9	Gjirokaster	277,510	11,742	17,698	21,217	50,657	18.25%
10	Fier	763,518	26,438	36,751	60,079	123,268	16.14%
Total		6,328,430	162,726	389,517	751,138	1,303,381	20.60%
			12.5%	29.9%	57.6%		

Nga analiza e llogaritjes së humbjeve teknike të kompanisë OSHEE.sh për vitin 2015 arrijmë në këto përfundime :

- Del e domosdoshme vazhdimi i zëvendësimit të rrjetit 6/10 kV me rrjetin me tension 20 kV.
- Zëvendësimi i rrjeteve TU me përcjellësa ajror të zhveshur me përcjellësa ajror të izoluar me vetëmbajtje ABC
Në tabelën e mëposhtme jepen humbjet teknike në përqindje të ndarë sipas niveleve të tensionit në bazë të energjisë elektrike aktive që ushqejnë këto rrjeta të tensionit:

Un (kV)	HT %
35	6.74%
6	9.10%
10	10.14%
20	2.51%
0.4	13.00%

5. PËRFUNDIME

- Humbjet teknike paraprake të llogaritura në vlerën 20.60% do të shërbejnë si një nga treguesit kryesorë për ndarjen apo planifikimin e humbjeve për vitin 2016.
- Investimet e reja duhet të përqëndrohen kryesisht:
 - në zonat që mbulohen nga fidera me humbje teknike të larta kryesisht fiderat 6,10, kV;
 - në zonat informale dhe ato me rrjet të pazhvilluar dhe jashtë çdo kushti teknik;
 - në zonat me konsum të lartë energjie elektrike dhe humbje të larta joteknike .

3. Për të reduktuar nivelin e humbjeve teknike në rrjetin elektrik të shpërndarjes duhet :

- Zëvendësimi rrjetit shpërndares 6/10/35 kV me rrjetin me tension 20 kV;
- Zëvendësimi i rrjetave TU me përcjellësa ajror të zhveshur (përfshirë rrjetin elektrik informal) me përcjellësa ajror të izoluar me vetëmbajtje ABC;
- Ndërtimi i nënstacioneve elektrike të rinj me nivel tensioni 110/20 kV të cilët do të shërbejnë për zëvendësimin e nënstacioneve aktuale 35/10 kV dhe 35/6 kV .

IV. SHPENZIMET PËR MBULIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE

Llogaritja e shpenzimeve për mbulimin e humbjeve si pjesë e tarifës së Operatorit të Shpërndarjes dhe për rrjedhojë edhe të tarifës së transmetimit varet nga humbjet teknike mesatare në rrjet dhe sasia e energjisë së shitur. Përlllogaritja e sasisë së energjisë së nevojshme në rrjet dhe sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve është bazuar në formulat si më poshtë:

- Sasia e energjisë së nevojshme në rrjet (S) llogaritet:

$$S = P / (100\% - Ht)$$

ku:

P – Sasia e energjisë që do të shitet.

Ht – Humbjet teknike mesatare në %

- Sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve (H) llogaritet:

$$H = S * Ht$$

Sa më lart nisur nga parashikimi se sasia e energjisë që do të shitet në vitin 2016 është 4,715 GWH dhe humbjet mesatare teknike nga studimi përfundimtar i vitit 2015 (përmbledhja e të cilit është pjesë e këtij studimi), duke zbritur efektin e uljes prej 1% nga investimet 2015-2016, rezultojnë të jenë 20.6%, sasia e energjisë së nevojshme në rrjet është 5,939 GWH. Ndërsa sasia e energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve rezulton të jetë 1,223 GWH.

Çmimi i energjisë së importuar për vitin 2016 planifikohet të jetë 7.1 Lekë /KWh.

Shpenzimet e nevojshme për mbulimin e humbjes së llogaritur sa më lart rezultojnë të jenë 8,686 milion Lekë. Kosto e transmetimit nga OST bazuar në çmimin e transmetimit dhe sasinë e humbjeve llogaritur më sipër rezulton të jetë 795 milion Lekë.

Shpenzimet për mbulimin e humbjeve teknike të shpërndarjes së energjisë për vitin 2015 pritet të jenë 9,481 milion Lekë.

V. PËRLLOGARITJA E SHPENZIMEVE OPERATIVE (OPEX)

5.1 Përmbledhje për shpenzimet operative

Përlllogaritja e Shpenzimeve Operative për vitin 2016 u mbështet në parashikimin e kryer gjatë procesit të buxhetimit i cili u aprovua nga Këshilli Mbikqyrës dhe pasi shqyrtua dhe vlerësua nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, u aprovua më pas nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes.

Rezultatet e jashtëzakonshme të arritura gjatë vitit 2015 ishin frut i intensifikimit të punës udhëhequr nga administrimi i ri i shoqërisë nëndryshim të metodave të mëparshme. Këto metoda intensifikuese u shoqëruan me rritje relative të shpenzimeve operative të cilat mundësuan rritjen e performancës. Viti 2015 ishte vit i analizave dhe programimit të një rritjeje të qëndrueshme të shoqërisë në vitet në vazhdim. Për vitin 2016 shoqëria ka planifikuar rritje të shpenzimeve thuajse në të gjitha zërat në funksion të përmirësimit të treguesve të aktivitetit kryesor të kompanisë atij tëshpërndarjes dhe shitjes së energjisë.

Rritja e planifikuar lidhet kryesisht me ato zëra të cilat kanë ndikim të drejtperdrejtë në rritjen e qëndrueshme të performancës së shoqërisë sikurse janë shpenzimet për materiale konsumi, mirëmbajtje, ligjore dhe përmbarimore. Shpenzimet operative të mirëmbajtjes gjatë vitit 2015 nuk u realizuan sipas planit, kjo pasi pati vonesa si në hartimin e një plani të detajuar ndërhyrjeje ashtu edhe në prokurimin e materialeve elektrike për shkak të aprovimit të vonuar të buxhetit 2015 nga Këshilli Mbikqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme, ku shkaqet lidhen kryesisht me organizimin e ri të shoqërisë në ndryshim të statusit të saj me kalimin e saj nga një shoqëri me kapital privat në një shoqëri me kapital shtetëror, duke ndryshuar një sërë rregullash të brendëshme të funksionimit për t'i përshtatur ato me rregullat dhe rregulloret e shoqërive me kapital shtetëror.

Për më tepër në tabelën krahasuese më poshtë janë vendosur treguesit e Shpenzimeve Operative për vitet 2012-2015 si dhe treguesit e pritshëm për vitin 2016.

Grupi i Llog	OSHEE OPEX (000 / ALL)	2012	2013	2014	2015	2016
						Buxhet
C01	Shpenzime materiale dhe konsumi	252,551	308,090	338,797	293,899	416,368
C20	Shpenzime për personelin	3,251,884	3,120,311	3,342,191	4,171,653	6,362,767
C50	Mirembajtje	503,925	357,208	922,948	1,388,034	3,299,183
C70	Penalitete dhe gjoba	383,051	5,414,936	4,375,081	750,647	-
C91	Sherbime Korporate	1,275,871	120,317	-	-	-
C92	Maredhenie me Publikun dhe Marketing	61,229	51,796	534	94,825	110,210
C93	Qera	324,255	295,588	290,226	334,414	537,138
C94	Sherbime Postare dhe Komunikimi	696,621	549,020	558,735	611,799	736,203
C95	Shpenzime Teknologjia e informacionit	16,245	20,196	27,956	35,378	380,242
C96	Shpenzime Ligjore	212,754	113,268	253,686	84,480	635,462
C97	Konsulence dhe Auditim	98,828	36,666	20,142	73,280	332,374
C90	Te tjera	1,354,137	932,978	598,457	687,799	1,562,854
	Totali i Shpenzimeve Operative	8,431,352	11,320,374	10,728,753	8,526,207	14,372,801

Disa nga zërat e shpenzimeve si Shpenzimet e Personelit, Shpenzimet e mirëmbajtjes, Shpenzimet për Siguracionet dhe Shërbimi i Sigurimit pritet të kenë rritje të ndjeshme shkaqet e të cilave janë vënë në dukje më poshtë.

Në kushtet e ndryshimit të strukturës organizative të kompanisë dhe funksionimit të saj bazuar në Drejtoritë Rajonale dhe mungesës së evidentimit të drejtpërdrejtë të kostove të ndara për Shpërndarjen dhe Shitjen e Energjisë elektrike, shpërndarja e kostove nuk mund të bëhet veçse duke përdorur koeficientë alokimi. Për këtë informacioni më i mirë i gjetur është ai i raportit ndërmjet shpenzimeve të Shpërndarjes dhe Shitjes të analizuar nga kompania CEZ Shpërndarje për aplikimin për periudhën rregullatore 2012 – 2014 e cila ka pasur një ndarje të qartë administrative të kompanisë në Shpërndarje dhe Shitje. Sipas këtij informacioni ndarja është bërë sipas këtij raporti:

Ndarja e OPEX sipas aplikimit të mëparshëm të CEZ Shpërndarje 2011

	2012	2013	2014	2015	2016
OPEX Shpërnd	6,681,238	8,970,580	8,501,763	6,756,404	11,389,408
OPEX Shitje	1,750,114	2,349,794	2,226,990	1,769,803	2,983,393
TOTAL OPEX	8,431,352	11,320,374	10,728,753	8,526,207	14,372,801
% Shitje	20.76%	20.76%	20.76%	20.76%	20.76%
% Shpërndarje	79.24%	79.24%	79.24%	79.24%	79.24%

Analizat më poshtë përfshijnë shpenzimet operative për Operatorin e Shpërndarjes dhe atë të Furnizimit në tërësi.

5.2 Shpenzime materiale dhe konsumi.

Shpenzimet për karburant dhe kancelari zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve. Shoqëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kontrollin dhe uljen e shpenzimeve në këtë zë duke tentuar normimin e shpenzimeve për aktivitetet bazë me të cilat lidhen këto shpenzime. Parashikimi bazohet në kostot e pritshme 2015 dhe inflacionin 2016.

Në rritje të efikasitetit financiar të përdorimit të fondeve, shoqëria ka marrë masa për të lidhur kontrata specifike për shërbimin e printimit që kanë ulur ndjeshëm kostot e tij. Ka një plan të detajuar sipas njësive organizative të shpenzimeve për karburante duke kontrolluar dhe rritur përdorimin me efikasitet të këtij shpenzimi, megjithatë për shkak të ndryshimit të strukturës së organizimit të shoqërisë me bazë fideri brënda njësive organizative të cilat do të rrisin kontrollin mbi asetet e kompanisë duke rritur efikasitetin e përdorimit të tyre për të ulur humbjet dhe rritur arkëtimet në vitin në vazhdim 2016, shpenzimet për karburante do të rriten. Organizimi i ri mbi bazë fiderash është provuar tashmë në efikasitetin e tij në projektet pilot të filluar në vitin 2015.

Si rezultat i rritjes së shpenzimeve për karburante shpenzimet gjithsej në këtë zë do të rriten rreth 28%.

5.3 Shpenzime për personelin

Ristrukturimi i skemës organizative të Shoqërisë si dhe plani i masave në kuadrin e ndërhyrjes dhe të aksionit për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve janë shoqëruar me rritjen e numrit të punonjësve dhe rrjedhimisht edhe me rritjen e shpenzimeve të personelit.

Struktura e re organizative në kuadër të aksionit të ndërmarrë dhe të ndryshimeve tranzitore ka planifikuar një rritje prej rreth 5% të personelit në vitin 2016. Krahas kësaj për vitin 2016 shoqëria ka parashikuar një rritje të ndjeshme të pagave të punonjësve. Sipas studimit të kryer nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, pagat shumë të ulta të punonjësve që operojnë në terren, kryesisht elektrikistë dhe faturistë të cilat kanë mbetur të pandryshuara prej vitesh, jo vetëm që nuk justifikojnë vlerën e punës së tyre por bëhen shpesh justifikim për uljen e performancës si dhe të abuzimeve të ndryshme. Shoqëria mendon që pagat e përputhura me shpërblimin sipas vlerës së tregut do të rrisë përgjegjshmërinë në punë si dhe performancën e shoqërisë.

5.4 Shpenzimet për Mirëmbajtje

Riparimet në rrjetin shpërndarës elektrik të kompanisë zënë peshën kryesore në këtë zë të shpenzimeve.

Rjeti shpërndarës TL/TM/TU që menaxhohet nga OSHEE është i ndarë sipas kategorive si vijojnë :

N/stacione 110/35/20/10/6 kV

N/stacione 110/20 kV

N/stacione 35/10 kV

N/stacione 35/6 kV

Rrjet shpërndarës TM 35 kV

Rrjet shpërndarës TM 20 kV

Rrjet shpërndarës TM 10/6 kV

Rrjet shpërndarës TU 0.4 kV

Më poshtë po ju paraqesim të dhënat teknike të rrjetit shpërndarës TL/TM/TU që menaxhohet nga OSHEE sh.a.

Kategoria e rrjetit shpërndarës	Të dhënat teknike të rrjetit		Mosha mesatare e rrjetit /pajisje
	Numri	km	vjet
N/stacionet 110/35/20/10/6 kV	159		38
N/stacionet 110/20	14		12
Rrjeti shpërndarës 35 kV		1,122	40
Rrjeti shpërndarës 10 kV		7,539	40
Rrjeti shpërndarës 6 kV		5,435	40
Rrjeti shpërndarës 20 kV		1,517	12

Rrjeti shpërndarës 0.4 kV		29,000	38
Transformatorët 110/35/20/10/6 kV		312	38
Transformatorët 35/10/6 kV			
Transformatorët 20/0.4		4,056	12
Transformatorët 10/0.4 kV		9,524	35
Transformatorët 6/0.4 kV		11,016	35

Siç shihet, nga tabela e mësipërme, gjendja teknike e rrjetit shpërndarës nuk i përmbush kushtet teknike të shfrytëzimit, pasi në rrjetin shpërndarës ka shume vite që nuk investohet siç kërkojnë kriteret e menaxhimit në Kompanitë e Shërbimeve të Konsumatorëve.

Problematikat :

- Rrjetet ajrore 35/10/6 kV janë të amortizuara, jo vetëm për mungesën e investimeve, por edhe për shkak të vjetërsisë së tyre, duke sjellë si pasojë rritjen e numrit të ndërprerjeve, kohëzgjatjen e ndërprerjeve, pra me pak fjalë përkeqësim në treguesit e cilësisë së furnizimit me energji të konsumatorëve. Gjithashtu, në zonat rurale, veçanërisht, ka fidera gjatësia e të cilave varion nga 30-120 km si dhe seksionet e përcjellësave janë nga më të ndryshmet dhe rrethorë duke sjellë jo vetëm përkeqësim në treguesit e cilësisë por edhe efekt në rritjen e humbjeve teknike.
- Gjatësia e rrjetit TU është rreth 29,000 km, një pjesë shumë e vogël e tij është zëvendësuar me kabëll ABC, zëvendësim i cili në total përfshin rreth 1200 km. Si pasojë e ndërhyrjeve përgjatë viteve në zonat periferike të qyteteve, nga banorët që kanë migruar, si dhe në zonat rurale, gjendja teknike e rrjeteve shpërndarës TU është përkeqësuar jashtë gjithë kriterëve dhe normave teknike. Mungesa e investimeve në këto zona, si dhe mungesa e meremetimeve të mëdha, kanë sjellë si pasojë që gjendja teknike e rrjetit të mos plotësojë furnizimin me energji elektrike dhe me cilësi të konsumatorëve. Për më tepër kjo gjendje :

1. Është burimi më i madh i humbjeve teknike dhe joteknike në rrjetet shpërndarës TU
2. Është burim i aksidenteve për punonjësit e Kompanisë dhe Komunitetin .

Ndërhyrjet e kryera gjatë vitit 2015 e në vazhdim në vitin 2016, përfshijnë rrjetet shpërndarës 35/10/6/0.4 kV si dhe N/stacionet dhe kabinat transformuese TM/TU, specifikisht :

1. Mirëmbajtje të linjave 35 kV për rritjen e cilësisë së transmetimit të energjisë elektrike në rrjetin shpërndarës.
2. Mirëmbajtje të linjave TM 10 kV për rritjen e cilësisë së furnizimit të konsumatorëve.
3. Mundësinë e kthimit të linjave më të ngarkuara dhe të gjata nga 6 kV ne 10 kV, duke përdorur strukturën ekzistuese të linjës dhe fuqizuar pjesën e përcjellësave dhe izolacionit, i cili mundëson rritjen e fuqisë transmetuese .
4. Mirëmbajtje të rrjetit shpërndarës TU, zëvendësimin e kaptave të para dhe tepër të dëmtuara duke përdorur :

-
- ✓ strategjinë e rritjes së seksioneve të përcjellësave në zonat rurale
 - ✓ Zëvendësimin e segmenteve të rrjetit TU më të dëmtuara, në zonat periferike dhe ato rurale, me elementë rrethore në gjendje sipas kushteve teknike të shfrytëzimit, zëvendësim i cili sjell si pasojë rritjen e cilësisë së furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve teknike dhe joteknike.
5. Mirëmbajtjen e kabinave të transformimit TM/TU, duke filluar nga pjesa ndërtimore e tyre , mirëmbajtja e pajisjeve komutuese , transformatorëve dhe paneleve TU, e cila rrit cilësinë e kushteve teknike të shfrytëzimit të impianteve elektrike shpërndarëse.
 6. Mirëmbajtjen e N/stacioneve , të cilat siç shihet nga tabela e mësipërme janë tepër të amortizuara dhe kanë një ndikim të madh në treguesit e cilësisë së transmetimit dhe në nivelin e humbjeve. Përsa i përket mirëmbajtjes do të kryhen punime dhe zëvendësime në qarqet primare dhe sekondare si dhe në pajisjet komutuese tepër të dëmtuara dhe të shuntuara (rreth 40 % e pajisjeve)
 7. Mirëmbajtja nga pikëpamja ndërtimore dhe infrastrukturës së shërbimit në N/stacione, gjendja e të cilave është tepër kritike pasi provokon difekte të rënda në pajisje dhe nxjerrjen jashtë pune të tyre, si në disa raste nxjerrjen totale jashtë pune të N/stacionit, si psh : rasti i N/stacionit në Gorisht , Belsh etj
 8. Mirëmbajtja e ambjenteve të punës së Repartit të Riparimit të Transformatorëve, duke e sjellë në kushte shfrytëzimi brenda standarteve, që kërkojnë operacionet e punës, të cilat zhvillohen në këtë Repart.
 9. Mirëmbajtja e rrjetit shpërndarës kabllor TM/TU, duke zëvendësuar pjesët e dëmtuara, pasi trashëgohen shumë segmente të dëmtuar në këtë rrjet, për arsye të ndërhyrjeve të paligjshme dhe ndërtimeve pa leje, të cilat kanë prekur trasenë e këtyre rrjeteve dhe për pasojë kanë sjellë edhe humbjen e fleksibilitetit të skemave të furnizimit duke e bërë këtë rrjet tepër të ngurtë.
 10. Verifikimi dhe riparimi i linjave ajrore TM/TU të cilat, si pasojë e ndërtimeve pa leje, janë të vendosura në distancë jashtë normave të Sigurisë së Komunitetit dhe të impianteve elektrike.
 11. Riparimi i kasetave shpërndarëse TU të bokseve kolektive , të cilat në gjendjen e sotme janë në kundërshtim flagrant të Rregullores së Shfrytëzimit dhe Sigurimit teknik, si në gjendjen teknike ashtu edhe në atë të sigurisë së punonjësve dhe Komunitetit. Kjo gjendje ndikon edhe në uljen e efektivitetit i cili parashikon të bëhet në sistemin e matjes në bokset kolektive.
 12. Mirëmbajtja e linjave furnizuese të objekteve të konsumatorëve të rëndësishëm si : Hidrovorë , Spitale , Ujësjellësa

Sa më sipër është detajuar më tej plani i ndërhyrjes, sipas studimit bashkëngjitur, dhe po vazhdon puna për zbatimin e tij. Prandaj edhe shpenzimet për riparimin e ndërtesave dhe të makinerive dhe pajisjeve si pjesë e planit të ndërhyrjes janë planifikuar të rritura rreth 26% në krahasim me planin e vitit 2015. Duhet theksuar se për shkak të vonesës në prokurime dhe

sikundër u theksua më lart plani i riparimeve gjatë vitit 2015 pati një realizim të ulët por kjo nuk e zvogëlon nevojën imediate të riparimit të aseteve dhe realizimin e tyre gjatë vitit 2016.

Aksioni i ndërmarrë për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve ka evidentuar nevojën e shtimit të kolaudimit të matësave tejet asaj të parashikuar prandaj në këtë zë ka patur një tejkalim të ndjeshëm prej rreth 6% nga ai i planifikuar për vitin 2015 dhe po kështu edhe për vitin 2016 planifikohet një rritje prej rreth 16% në krahasim me realizimin e vitit 2015.

5.5 Penalitete dhe Gjoha.

Megjithëse shpenzimet për penalitete dhe gjoha vazhdojnë të jenë të larta gjatë vitit 2015 rreth 751 milion Lekë, kryesisht si pasojë e detyrimeve ligjore që lidhen me periudha e administrimeve të viteve të mëparshme, duke zbatuar metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave këto shpenzime nuk janë marrë parasysh në përlllogaritjen e tarifës.

5.6 Shërbime korporate

Kompania nuk ka tashmë shërbime korporative. Ky zë është aty vetëm për krahasim me periudhat e mëparshme (vitin 2012).

5.7 Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing

Shpenzimet për marrëdhëniet me publikun dhe marketing janë planifikuar mbi bazën e shpenzimeve historike dhe nevojës reale për marketing dhe fushata publicitare për ndërgjegjësimin e popullsisë dhe uljen e humbjeve në rrjet. Këto shpenzime kanë karakter sezonal dhe janë realizuar sipas planit të miratuar për vitin 2015.

5.8 Shpenzime për Qera

Rritja e numrit të Qendrave të Kujdesit në kuadër të aksionit për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve ka rritur domosdoshmërisht shpenzimet për qeratë e objekteve gjatë vitit 2015 në krahasim me ato të vitit 2014, të cilat janë sidoqoftë më të ulta se ato të planifikuara. Për vitin 2016 është parashikuar rritje e cila vjen si pasojë e rritjes së numrit të mjeteve në përdorin për shkak të ndryshimit të strukturës mbi bazë fideri (për të njëjtin shkak që do të rriten edhe shpenzimet për karburante sikurse u tregua më lart). Krahas kësaj është parashikuar edhe një rritje si pasojë e inflacionit.

5.9 Shërbime Postare dhe Komunikimi

Këto shpenzime lidhen kryesisht me shpërndarjen mujore të faturës për klientët dhe me tarifat për arkëtimin e faturave nga Posta Shqiptare. Planifikimi i shpenzimeve për këto zëra u mbështet kryesisht në koston historike në realizimin dhe buxhetin 2015 si dhe rritjen e mundshme për shkak të inflacionit.

Në të dyja këto lloj shpenzimesh gjatë vitit 2015 ka patur tejkalim në krahasim me vitin 2014 dhe po kështu janë parashikuar me rritje edhe për vitin 2016. Këto tejkalime të paparashikuara në planin e aprovuar lidhen me:

- Me shpërndarjen e faturës numri i abonentëve të cilëve u dërgohet faturë është rreth 1.2 milion nga rreth 0.9 milion të llogaritur duke i rritur shpenzimet në këtë zë me rreth 6% për vitin 2016 në krahasim me buxhetin 2015.
- Me arkëtimin e faturës, ku si pasojë e rritjes së arkëtimeve me një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme dhe kontratës së shërbimit të arkëtimit prej 1.85% mbi shumën e arkëtuar shpenzimet në këtë zë parashikohet të rriten me rreth 3% në 2016 në krahasim me buxhetin 2015.

5.10 Shpenzime të Teknologjisë së Informacionit

Rritja e investimeve në Teknologjinë e Informacionit e ka bërë të domosdoshme rritjen e shpenzimeve të mirëmbajtjes së këtyre investimeve. Gjatë vitit 2016 investimet në Teknologjinë e Informacionit do të rriten 3 herë prandaj edhe do të rritet mirëmbajtja e tyre e cila është parashikuar të jetë rreth 380 milion Lekë.

5.11 Shpenzime Ligjore

Shpenzimet ligjore janë ulur në krahasim me vitin 2014 me të njëjtin trend që janë planifikuar për vitin 2015 dhe po kështu janë planifikuar edhe për vitin 2016.

5.12 Konsulencë dhe Auditim

Gjatë vitit 2016 shpenzimet e konsulencës dhe të auditimit janë planifikuar të rriten. Ristrukturimi i shoqërisë dhe ndarja e saj organizative në Operatorin e Shpërndarjes dhe atë të Shitjes si dhe përgatitjet për operimin në kushtet e tregut të hapur të energjisë do të kërkojnë shtimin e shpenzimeve të konsulencës dhe auditimit krahas atyre normale.

5.13 Shpenzime të tjera.

Rritja e shpenzimeve të tjera lidhet kryesisht me shpenzimin për verifikimin dhe pastrimin e të dhënave të debisë së trashëguar në sistemin Billing i cili do të përfundojë gjatë vitit 2016. Ky verifikim do të ketë ndikim të madh edhe në rivlerësimin e zbritjeve nga llogaritë e arkëtueshme në kontabilitet dhe që do të rivlerësojë edhe humbjet nga vitet e kaluara në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Rritja e shpenzimeve të Shërbimit të Sigurimit, Primit të sigurimit dhe ato për printimin e faturave të cilat zënë një peshë të rëndësishme në këtë zë të shpenzimeve kanë kryesisht karakter inflativ.

VI. ASETET BAZË TE RREGULLUARA

6.1 Investimet (CAPEX)

6.1.1 Vështrim i përgjithshëm

Kalimi i aksioneve në pronësi të Qeverisë Shqiptare ka bërë të mundur gjetjen e fondeve për realizimin e investimeve të nevojshme përgjatë vitit 2015 dhe në vazhdim për 2016 të cilat do të synojnë në:

- a. Uljen e humbjeve teknike dhe jo-teknike në të gjithë rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.
- b. Fuqizimin e kapaciteteve të furnizimit duke parë prioritete për zonat më problematike të vendit.
- c. Rritjen e koeficientëve të shfrytëzimit duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimit.

Gjendja e rrënuar e aseteve të kompanisë përshkruar edhe në paragrafin 2.4 e bën të domosdoshme ndërhyrjen me investime në rrjetin e shpërndarjes.

Për një kohë të gjatë ka pasur mungesë shumë të madhe të realizimit të investimeve në rrjetin e shpërndarjes sikurse ka patur edhe mosrealizim të ndjeshëm të planeve të investimeve. Kompania e kishte të pamundur të kryente investime serioze gjatë vitit 2013 dhe 2014 si për pasojë të gjendjes në administrim të përkohshëm që vendos pengesa ligjore në administrimin efikas të aseteve, ashtu edhe për mungesë të fondeve.

Historiku i realizimit të investimeve paraqitet si më poshtë:

6.1.2 Mosrealizimi për vitin 2011

Në tabelën më poshtë paraqitet realizimi i investimeve të kapitalizuara (në Lekë) për vitin 2011 të cilat në aplikimin për tarifë të këtij viti ishin planifikuar 2.4 miliard Lekë dhe sikundër mund të vërehet në tabelën e mëposhtme u realizuan vetëm 1,95 miliard Lekë me një mosrealizim prej 0.45 miliard Lekësh.

Nr	Shtesat 2011		
	Pershkrimi	Klasa e asetit	Shtesat 01.01-31.12.2011
1	Tokë me ndërtime	3110	
2	Përmirësimi i tokës	3120	
3	Ndërtesa teknike	2110	42,850,591.09
4	Ndërtesa të tjera	2120	302,204.39
5	Makineri dhe paisje	2230	268,499,578.16
6	Transformatorë	2231	153,970,877.73
7	Linja ajrore(TM)	2232	174,653,806.80
8	Linja ajrore(TU)	2233	108,771,296.15
9	Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	-

10	Linja nëntokësore TM	2232	-
11	Matësa	2240	990,857,154.86
12	Mjete transporti	2260	6,831,470.00
13	Paisje zyrash	2910	17,590,861.77
14	Paisje kompjuterike	2250	95,700,655.72
15	Kompjutera	2251	37,556,891.50
16	Software	1310	9,264,492.00
17	Liçensa	1410	39,713,427.55
	Totali		1,946,563,307.72

6.1.3 Mosrealizimi për vitin 2012

Në tabelën më poshtë paraqitet realizimi i investimeve të kapitalizuara (në Lekë) për vitin 2012 të cilat në aplikimin për tarifë të vitit 2011 ishin planifikuar 6.5 miliard Lekë dhe sikundër mund të vërehet në tabelën e mëposhtëme u realizuan vetëm 0,7 miliard Lekë me një mosrealizim prej 5.8 miliard Lekësh.

Nr	Shtesat 2012		
	Pershkrimi	Klasa e asetit	Shtesat 01.01-31.12.2012
1	Tokë me ndërtime	3110	
2	Përmirësimi i tokës	3120	
3	Ndërtesa teknike	2110	3,963,828.24
4	Ndërtesa të tjera	2120	
5	Makineri dhe paisje	2230	27,650,512.44
6	Transformatorë	2231	133,719,988.72
7	Linja ajrore(TM)	2232	4,091,565.36
8	Linja ajrore(TU)	2233	591,670.28
9	Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	-
10	Linja nëntokësore TM	2232	-
11	Matësa	2240	555,742,689.03
12	Mjete transporti	2260	3,892,260.00
13	Paisje zyrash	2910	1,636,516.02
14	Paisje kompjuterike	2250	2,308,198.96
15	Kompjutera	2251	2,689,938.91
16	Software	1310	17,555,940.30
17	Liçensa	1410	12,039,971.62
	Totali		765,883,079.88

6.1.4 Realizimi i investimeve për vitin 2013

Në tabelën më poshtë paraqitet realizimi i investimeve të kapitalizuara (në Lekë) për vitin 2013 të cilat në aplikimin për tarifë të vitit 2011 ishin planifikuar 6.7 miliard Lekë dhe sikundër mund të vërehet në tabelën e mëposhtme u realizuan vetëm 0,4 miliard Lekë me një mosrealizim prej 6.3 miliard Lekësh.

Për shkak të kalimit në administrim të përkohshëm investimet në vitin 2013 u kryen vetëm si investime të domosdoshme për furnizimin e shtesës së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike ose si pasojë e zëvendësimit të domosdoshëm të aseteve të dëmtuara për shkak të defekteve dhe avarive të shumta.

Për shkak të problemeve ligjore lidhur me shtesat dhe pakësimet në kushtet e shoqërisë në administrim të përkohshëm plani i investimeve është miratuar paraprakisht nga ERE.

Duhet theksuar se investimet në rrjet gjatë vitit nuk ishin 448 milion Lekë si në tabelën e mëposhtme por 1,696 milion Lekë pasi pjesa tjetër prej 1,248 milion Lekë nuk arritën të kapitalizohen. Kapitalizimi i tyre është në proces gjatë vitit 2014 dhe 2015.

Nr	Shtesat 2013		
	Pershkrimi	Klasa e asetit	Shtesat 01.01-31.12.2013
1	Toke me ndertime	3110	
2	Permiresimi I tokes	3120	
3	Ndertesa teknike	2110	4,265,271.07
4	Ndertesa te tjera	2120	
5	Makineri dhe paisje	2230	53,500,858.19
6	Transformatore	2231	94,760,703.19
7	Linja ajrore(TM)	2232	87,348,620.51
8	Linja ajrore(TU)	2233	62,148,250.94
9	Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	-
10	Linja nentokesore TM	2232	-
11	Matesa	2240	8,100.00
12	Mjete transporti	2260	24,693,970.75
13	Paisje zyrash	2910	14,917,303.21
14	Paisje kompjuterike	2250	19,780,410.57
15	Kompjuteri	2251	4,618,750.13
16	Softëare	1310	-
17	Liçensa	1410	82,422,438.94
	Totali		448,464,677.50

6.1.5 Realizimi i investimeve për vitin 2014

Në tabelën më poshtë paraqitet realizimi i investimeve të kapitalizuara (në Lekë) për vitin 2014 të cilat në aplikimin për tarifë të vitit 2011 ishin planifikuar 7 miliard Lekë dhe sikundër mund të vërehet në tabelën e mëposhtme ka një realizim prej vetëm 1.2 miliard Lekë me një mosrealizim prej 5.8 miliard Lekësh.

Edhe përgjatë vitit 2014 investimet lidhen kryesisht me zëvendësime të domosdoshme të aseteve të dëmtuara dhe shtesa të domosdoshme të rrjetit si dhe është duke përfshirë një pjesë e aseteve në proces nga vitet e mëparshme që do të kapitalizohen.

Nr	Shtesat 2014		
	Pershkrimi	Klasa e asetit	Shtesat 01.01-31.12.2014
1	Tokë me ndërtim	3110	-
2	Përmirësimi i tokës	3120	-
3	Ndërtesa teknike	2110	94,154,255.24
4	Ndërtesa të tjera	2120	-
5	Makineri dhe paisje	2230	321,002,131.82
6	Transformatorë	2231	192,712,742.17
7	Linja ajrore(TM)	2232	114,120,578.34
8	Linja ajrore(TU)	2233	207,212,339.96
9	Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	-
10	Linja nëntokësore TM	2232	159,483,852.88
11	Matësa	2240	40,963,063.63
12	Mjete transporti	2260	41,853,688.71
13	Paisje zyrash	2910	2,726,004.72
14	Paisje kompjuterike	2250	29,603,491.80
15	Kompjuterat	2251	2,977,796.05
16	Software	1310	696,000.00
17	Liçensa	1410	627,132.36
	Totali		1,208,133,077.68

6.1.6 Realizimi i pritshëm për vitin 2015

Plani i investimevetë vitit 2015 (në Lekë) u mbështetet kryesisht në financimin nga burime të brendshme si dhe u mendua se do të lëvrohet nga kredia mbështetese Bankës Botërore e cila nuk arriti të jetë efektive. Vlera e kapitalizuar e investimeve të vitit 2015 jepet në tabelën më poshtë ndërsa pjesa tjetër e planit prej 5.8 miliard Lekë është në proces kapitalizimi dhe do të kapitalizohet në fillim të vitit në vazhdim 2016:

Nr	Shtesat 2015		
	Pershkrimi	Klasa e asetit	Shtesat 01.01-31.12.2015
1	Tokë me ndërtime	3110	-
2	Përmirësimi i tokës	3120	-
3	Ndërtesa teknike	2110	89,354,807.28
4	Ndërtesa të tjera	2120	4,794,623.85
5	Makineri dhe paisje	2230	357,336,577.35
6	Transformatorë	2231	397,746,742.91
7	Linja ajrore(TM)	2232	122,277,753.87
8	Linja ajrore(TU)	2233	24,402,365.45
9	Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	-
10	Linja nëntokësore TM	2232	28,006,199.73
11	Matësa	2240	96,891,999.12
12	Mjete transporti	2260	33,376,740.00
13	Paisje zyresh	2910	8,321,267.05
14	Paisje kompjuterike	2250	239,001,753.20
15	Kompjuteri	2251	37,027,300.52
16	Software	1310	75,489,200.00
17	Liçensa	1410	112,071,300.00
	Totali		1,626,098,630.33

6.1.7 Plani i investimeve për vitin 2016

Plani i investimeve të vitit 2016, si më poshtë (në Lekë) mbështetet kryesisht në financimin nga burime të brendshme, mundësi të krijuara nga rritja e arkëtimit dhe ulja e kostos së blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve, si dhe nga kredia që do të lëvrohet me mbështetje të Bankës Botërore duke patur një financim total prej 12.861 miliard Lekë deri në fund të vitit 2016. (Në totalin e sipërpërmendur përfshihet edhe vlera e investimeve në process kapitalizimi nga viti 2015.)Kredia në kushte shumë të favorshme do të vazhdojë të disbursohet në investime edhe në vitet në vazhdim.

Nr	Shtesat 2016		
	Pershkrimi	Klasa e asetit	Shtesat 01.01-31.12.2016
1	Tokë me ndërtime	3110	
2	Përmirësimi i tokës	3120	11,223,532
3	Ndërtesa teknike	2110	187,460,000
4	Ndërtesa të tjera	2120	694,575
5	Makineri dhe paisje	2230	2,425,444,358
6	Transformatorë	2231	275,981,360
7	Linja ajrore(TM)	2232	3,153,024,717
8	Linja ajrore(TU)	2233	2,859,585,041
9	Dispeceria dhe kontr.sistemit	2230	358,459,874

10	Linja nëntokësore TM	2232	652,721,242
11	Matësa	2240	1,237,890,079
12	Mjete transporti	2260	-
13	Paisje zyresh	2910	
14	Paisje kompjuterike	2250	1,363,520,000.00
15	Kompjuterat	2251	-
16	Software	1310	335,000,000.00
17	Liçensa	1410	-
	Totali		12,861,004,777

6.2 Amortizimi

Duke zbatuar të njëjtën metodologji sipas aplikimit për tarifë të CEZ Shpërndarje për tarifën e periudhës rregullatore 2012-2014 kemi ndarë asetet në asete të kapitalizuara të periudhës përpara privatizimit (të gjitha asetet deri më datë 31.05.2009) dhe në asete të kapitalizuara të periudhës pas privatizimit sipas të dhënave të trashëguara nga CEZ Shpërndarje që janë të plota për asetet deri në fund të vitit 2011 mbi të cilat u mbështet edhe aplikimi i vitit 2011 për periudhën rregullatore 2012 - 2014.

Amortizimi i grupit të parë të aseteve llogaritet duke u bazuar në kohëzgjatjen e dobishme të mbetur që aplikohet sipas klasës së asetit përkatës.

Amortizimi i grupit të dytë të aseteve llogaritet duke aplikuar normën përkatëse të amortizimit mbi vlerën kontabël bruto dhe neto të asetit individual, sipas rastit, në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar dhe rregulloret e vlefshme për vitin për të cilin llogaritet amortizimi.

Amortizimi për vitet 2012-2015

A) Amortizimi i Aseteve të Vjetra (para privatizimit) në periudhën 2012-2015

Vlera e aseteve të vjetra (para privatizimit) në 31 dhjetor 2012 e cila sipas të dhënave kontabël të trashëguara nga CEZ Shpërndarje ishte 29,243 milion Lekë, është amortizuar në mënyrë lineare sipas klasave respektive të aseteve, bazuar në llogaritjen e pjesës të mbetur të jetës.

Të dhënat e detajuara për amortizimin e Aseteve të Vjetra në periudhën 2012-2015 jepen në tabelat si vijon (në Lekë):

Amortizimi 2012 para blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
3110	Toke me ndertesa	1,008,433,529	0	0	1,008,433,529	0	1,008,433,529
3120	Permiresim i tokes	488,183,595	0	48,818,360	488,183,595	174,932,455	313,251,140
2110	Ndertesa	2,380,390,410	0	173,774,292	2,380,390,410	612,547,844	1,767,842,566
2120	Konstruksione	5,410,838	0	211,434	5,410,838	656,851	4,753,987
2230	Makineri pajisje 20%	2,159,004,646	0	204,011,645	2,159,004,646	926,789,971	1,232,214,675
2231	Makineri pajisje 5%	3,831,652,348	0	362,581,554	3,831,652,348	1,597,600,431	2,234,051,917
2233	Linja ajrore (TU)	11,022,664,097	0	1,182,595,160	11,022,664,097	4,258,584,664	6,764,079,433
2232	Linja ajrore (TM)	6,603,732,813	0	697,843,444	6,603,732,813	2,482,791,881	4,120,940,932
AL2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit		0	0	0		0
AL2230	Linja nentokesore (TM)		0	0	0		0
2240	Matesa	1,113,159,076	0	155,497,079	1,113,159,076	532,138,171	581,020,905
2260	Automjete	318,158,055	0	24,879,334	318,158,055	236,338,197	81,819,858
2910	Pajisje Zyre	70,826,633	0	6,880,080	70,826,633	43,786,976	27,039,658
2251	Kompjutera	238,063,083	0	13,346,006	238,063,083	219,266,142	18,796,941
2250	Pajisje IT	3,609,966	0	1,156,803	3,609,966	3,366,742	243,224
1410	Programe kompjuterike	0	0	0	0	0	0
1310	Liçensa	0	0	0	0	0	0
	Total	29,243,289,089.46	-	2,871,595,191.17	29,243,289,089.46	11,088,800,323.33	18,154,488,766.13

Amortizimi 2013 para blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
AL3110	Toke me ndertesa	1,008,433,529	0	0	1,008,433,529	0	1,008,433,529
AL3120	Permiresim i tokes	488,183,595	0	47,818,360	488,183,595	222,750,815	265,432,781
AL2110	Ndertesa	2,380,390,410	0	172,341,662	2,380,390,410	784,889,506	1,595,500,905
AL2120	Konstruksione	5,410,838	0	161,434	5,410,838	818,284	4,592,554
AL2230	Makineri pajisje 20%	2,159,004,646	0	176,725,423	2,159,004,646	1,103,515,394	1,055,489,252
AL2231	Makineri pajisje 5%	3,831,652,348	0	333,175,102	3,831,652,348	1,930,775,533	1,900,876,815
AL2233	Linja ajrore (TU)	11,022,664,097	0	1,219,253,391	11,022,664,097	5,477,838,054	5,544,826,043
AL2232	Linja ajrore (TM)	6,603,732,813	0	701,179,182	6,603,732,813	3,183,971,063	3,419,761,750
2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	0	0	0	0	0	0
2230	Linja nentokesore (TM)	0	0	0	0	0	0
AL2240	Matesa	1,113,159,076	0	154,974,948	1,113,159,076	687,113,119	426,045,958
AL2260	Automjete	318,158,055	0	23,399,992	318,158,055	259,738,189	58,419,866
AL2910	Pajisje Zyre	70,826,633	0	5,494,963	70,826,633	49,281,939	21,544,694
AL2251	Kompjutera	238,063,083	0	214,214	238,063,083	219,480,355	18,582,728
AL2250	Pajisje IT	3,609,966	0	243,224	3,609,966	3,609,966	0
AL1410	Programe kompjuterike	0	0	0	0	0	0
AL1310	Liçensa	0	0	0	0	0	0
	Total	29,243,289,089.46	-	2,834,981,893.11	29,243,289,089.46	13,923,782,216.44	15,319,506,873.02

Amortizimi 2014 para blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
3110	Toke me ndertesa	1,008,433,529	0	0	1,008,433,529	0	1,008,433,529
3120	Permiresim i tokes	488,183,595	0	40,518,800	488,183,595	263,269,614	224,913,981
2110	Ndertesa	2,380,390,410	0	155,540,591	2,380,390,410	940,430,096	1,439,960,314
2120	Konstruksione	5,410,838	0	155,952	5,410,838	974,236	4,436,602
2230	Makineri pajisje 20%	2,159,004,646	0	151,379,292	2,159,004,646	1,254,894,685	904,109,960
2231	Makineri pajisje 5%	3,831,652,348	0	283,487,067	3,831,652,348	2,214,262,600	1,617,389,748
2233	Linja ajrore (TU)	11,022,664,097	0	887,172,167	11,022,664,097	6,365,010,221	4,657,653,876
2232	Linja ajrore (TM)	6,603,732,813	0	581,873,360	6,603,732,813	3,765,844,423	2,837,888,390
AL2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	0	0	0	0	0	0
AL2230	Linja nentokesore (TM)	0	0	0	0	0	0
2240	Matesa	1,113,159,076	0	113,638,682	1,113,159,076	800,751,801	312,407,275
2260	Automjete	318,158,055	0	16,707,734	318,158,055	276,445,923	41,712,132
2910	Pajisje Zyre	70,826,633	0	4,378,284	70,826,633	53,660,224	17,166,410
2251	Kompjutera	238,063,083	0	211,772	238,063,083	219,692,128	18,370,955
2250	Pajisje IT	3,609,966	0	0	3,609,966	3,609,966	0
1410	Programe kompjuterike	0	0	0	0	0	0
1310	Liçensa	0	0	0	0	0	0
	Total	29,243,289,089.46	-	2,235,063,700.37	29,243,289,089.46	16,158,845,916.81	13,084,443,172.65

Amortizimi 2015 para blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
3110	Toke me ndertesa	1,008,433,529.05		-	1,008,433,529.05	-	1,008,433,529.05
3120	Permiresim i tokes	488,183,595.48		11,245,699.06	488,183,595.48	274,515,313.25	213,668,282.23
2110	Ndertesa	2,380,390,410.27		71,998,015.69	2,380,390,410.27	1,012,428,112.18	1,367,962,298.09
2120	Konstruksione	5,410,838.00		221,830.11	5,410,838.00	1,196,065.89	4,214,772.11
2230	Makineri pajisje 20%	2,159,004,645.72		209,232,190.79	2,159,004,645.72	1,464,126,876.22	694,877,769.50
2231	Makineri pajisje 5%	3,831,652,348.00		93,575,454.07	3,831,652,348.00	2,307,838,054.38	1,523,814,293.62
2232	Linja ajrore (TU)	11,022,664,096.99		269,472,510.86	11,022,664,096.99	6,634,482,732.07	4,388,181,364.92
2233	Linja ajrore (TM)	6,603,732,813.03		164,188,437.01	6,603,732,813.03	3,930,032,860.05	2,673,699,952.98
2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	-		-	-	-	-
2232	Linja nentokesore (TM)	-		-	-	-	-
2240	Matesa	1,113,159,076.23		62,481,455.08	1,113,159,076.23	863,233,255.89	249,925,820.34
2260	Automjete	318,158,054.76		8,342,426.43	318,158,054.76	284,788,349.04	33,369,705.72
2910	Pajisje Zyre	70,826,633.37		3,433,281.97	70,826,633.37	57,093,505.50	13,733,127.87
2250	Kompjutera	238,063,082.88		4,592,738.79	238,063,082.88	224,284,866.51	13,778,216.37
2251	Pajisje IT	3,609,965.68		-	3,609,965.68	3,609,965.68	-
1310	Programe kompjuterike	-		-	-	-	-
1410	Liçensa	-		-	-	-	-
	Total	29,243,289,089.46	-	898,784,039.87	29,243,289,089.46	17,057,629,956.67	12,185,659,132.79

B) Amortizimi i Aseteve të Reja pas privatizimit për periudhën 2009 – 2015.

Në përlllogaritjen e amortizimit të Aseteve të Reja sipas viteve janë marrë parasysh të gjitha asetet e reja të kapitalizuara pas privatizimit bazuar në periudhën e vënies në përdorim të asetit dhe klasën e klasifikimit të asetëve. Vlera e asetëve të reja deri ne 31.12.2012 bazuar në informacionin e trashëguar nga CEZ Shpërndarje ishte 6,259 milion Lekë.

Të dhënat e detajuara për amortizimin e Aseteve të Reja pas privatizimit 2012-2014 jepen në tabelat në vijim (në Lekë):

Amortizimi 2012 pas blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
3110	Toke me ndertesa	22,475,213	0	0	22,475,213	0	22,475,213
3120	Permiresim i tokes	266,878,065	0	12,814,297	266,878,065	26,099,679	240,778,386
2110	Ndertesa	349,311,227	3,963,828	10,645,092	353,275,055	21,067,890	332,207,165
2120	Konstruksione	92,636,790	0	5,753,927	92,636,790	11,548,658	81,088,132
2230	Makineri pajisje 20%	1,726,043,483	88,412,360	116,928,258	1,814,455,843	226,791,635	1,587,664,208
2231	Makineri pajisje 5%	877,126,992	72,958,141	51,044,142	950,085,133	98,340,835	851,744,298
2232	Linja ajrore (TU)	179,135,623	591,670	8,960,100	179,727,293	12,574,296	167,152,997
2232	Linja ajrore (TM)	377,516,849	4,091,565	18,976,551	381,608,414	30,938,328	350,670,086
AL2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	0		0	0	0	0
AL2230	Linja nentokesore (TM)	0		0	0	0	0
2240	Matesa	1,870,333,940	555,742,689	179,409,126	2,426,076,629	336,502,839	2,089,573,790
2260	Automjete	42,724,963	3,892,260	4,748,653	46,617,223	29,375,289	17,241,934
2910	Pajisje Zyre	84,711,036	1,636,516	6,667,672	86,347,552	34,074,484	52,273,067
2251	Kompjutera	175,181,244	2,689,939	52,853,106	177,871,182	138,726,935	39,144,248
2250	Pajisje IT	124,370,562	2,308,199	37,018,640	126,678,761	67,287,061	59,391,700
1410	Programe kompjuterike	61,006,670	12,039,972	23,948,585	73,046,642	37,997,175	35,049,467
1310	Liçensa	9,264,492	17,555,940	6,745,538	26,820,432	7,836,971	18,983,462
	Total	6,258,717,146.48	765,883,079.88	536,513,687.05	7,024,600,226.36	1,079,162,074.08	5,945,438,152.28

Amortizimi 2013 pas blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
AL3110	Toke me ndertesa	22,475,213	-	0	22,475,213	0	22,475,213
AL3120	Permiresim i tokes	266,878,065	-	13,817,241	266,878,065	39,916,919	226,961,145
AL2110	Ndertesa	353,275,055	4,265,271.07	10,709,445	357,540,326	31,777,335	325,762,991
AL2120	Konstruksione	92,636,790	-	5,803,927	92,636,790	17,352,586	75,284,204
AL2230	Makineri pajisje 20%	1,814,455,843	74,676,426.44	122,438,927	1,889,132,269	349,230,562	1,539,901,707
AL2231	Makineri pajisje 5%	950,085,133	73,585,134.94	54,565,187	1,023,670,268	152,906,022	870,764,246
AL2233	Linja ajrore (TU)	179,727,293	83,834,191.94	48,854,374	263,561,485	61,428,670	202,132,815
AL2232	Linja ajrore (TM)	381,608,414	65,662,679.51	50,530,874	447,271,094	81,469,203	365,801,891
2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	0	-	0	0	0	0
2230	Linja nentokesore (TM)	0	-	0	0	0	0
AL2240	Matesa	2,426,076,629	8,100.00	208,117,404	2,426,084,729	544,620,243	1,881,464,486
AL2260	Automjete	46,617,223	24,693,970.75	8,031,068	71,311,193	37,406,357	33,904,836
AL2910	Pajisje Zyre	86,347,552	14,917,303.21	9,204,718	101,264,855	43,279,202	57,985,653
AL2251	Kompjuter	177,871,182	4,624,928.04	35,868,133	182,496,111	174,595,068	7,901,043
AL2250	Pajisje IT	126,678,761	19,774,232.33	43,679,197	146,452,994	110,966,258	35,486,736
AL1410	Programe kompjuterike	73,046,642	82,422,438.94	23,046,394	155,469,081	61,043,569	94,425,512
AL1310	Liçensa	-	-	7,704,879	26,820,432	15,541,849	11,278,583
	Total	6,997,779,794.06	448,464,677.17	642,371,767.97	7,473,064,903.53	1,721,533,842.05	5,751,531,061.48

Amortizimi 2014 pas blerjes

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
3110	Toke me ndertesa	22,475,213	0	0	22,475,213	0	22,475,213
3120	Permiresim i tokes	266,878,065	0	21,116,801	266,878,065	61,033,720	205,844,345
2110	Ndertesa	357,540,326	94,154,255	27,714,205	451,694,582	59,491,540	392,203,042
2120	Konstruksione	92,636,790	0	5,809,409	92,636,790	23,161,995	69,474,795
2230	Makineri pajisje 20%	1,889,132,269	321,002,132	150,248,134	2,210,134,401	499,478,696	1,710,655,705
2231	Makineri pajisje 5%	1,023,670,268	192,712,742	77,168,931	1,216,383,010	230,074,952	986,308,058
2233	Linja ajrore (TU)	175,483,453	114,120,578	89,798,671	289,604,031	151,227,340	138,376,691
2232	Linja ajrore (TM)	535,349,127	207,212,340	11,738,913	742,561,467	93,208,115	649,353,351
AL2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	0	-	0	0	0	0
AL2230	Linja nentokesore (TM)	0	159,483,853	4,108,936	159,483,853	4,108,936	155,374,917
2240	Matesa	2,426,084,729	40,963,064	226,535,151	2,467,047,792	771,155,394	1,695,892,399
2260	Automjete	71,311,193	41,853,689	16,320,524	113,164,882	53,726,881	59,438,001
2910	Pajisje Zyre	101,264,855	2,726,005	9,021,032	103,990,860	52,300,234	51,690,625
2251	Kompjuter	182,496,111	2,977,796	6,816,927	185,473,907	181,411,995	4,061,911
2250	Pajisje IT	146,452,994	29,603,492	33,004,531	176,056,485	143,970,788	32,085,697
1410	Programe kompjuterike	155,469,081	696,000	7,762,901	156,165,081	68,806,470	87,358,611
1310	Liçensa	26,820,432	627,132	24,443,820	27,447,565	39,985,669	-12,538,104
	Total	7,473,064,904.53	1,208,133,077.68	711,608,884.55	8,681,197,982.21	2,433,142,726.60	6,248,055,255.61

	Pershkrimi	Vlera Bruto (BOP)	Shtesa	Amortizimi	Vlera Bruto (EoP)	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto
3110	Toke me ndertesa	22,475,213	0	0	22,475,213	0	22,475,213
3120	Permiresim i tokes	266,878,065	0	12,817,241	266,878,065	73,850,961	193,027,104
2110	Ndertesa	451,650,866	89,354,807	11,956,364	541,005,673	71,424,652	469,581,021
2120	Konstruksione	92,636,790	4,794,624	5,848,268	97,431,414	29,010,263	68,421,151
2230	Makineri pajisje 20%	2,209,062,762	357,336,577	160,551,203	2,566,399,339	660,876,237	1,905,523,102
2231	Makineri pajisje 5%	1,217,152,214	397,746,743	335,534,616	1,614,898,957	565,622,047	1,049,276,910
2233	Linja ajrore (TU)	449,087,884	122,277,754	461,309,903	571,365,638	612,537,243	-41,171,605
2232	Linja ajrore (TM)	342,520,000	24,402,365	95,606,343	366,922,365	188,814,459	178,107,907
2230	Desipeceria dhe kontr.sistemit	0	0	0	0	0	0
2232	Linja nentokesore (TM)	400,064,366	28,006,200	219,385,672	428,070,566	223,494,607	204,575,958
2240	Matesa	2,468,207,668	96,891,999	234,810,928	2,565,099,667	1,005,237,377	1,559,862,290
2260	Automjete	77,684,672	33,376,740	6,275,778	111,061,412	28,130,845	82,930,567
2910	Pajisje Zyre	103,261,845	8,321,267	12,984,576	111,583,112	64,536,153	47,046,959
2250	Kompjuter	175,956,783	239,001,753	30,144,540	414,958,536	174,566,376	240,392,160
2251	Pajisje IT	185,512,526	37,027,301	8,313,361	222,539,827	189,942,544	32,597,283
1310	Programe kompjuterike	64,098,532	75,489,200	17,725,459	139,587,732	32,667,870	106,919,862
